INDEP
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT POLICY
INSTITUTI PËR POLITIKA ZHVILLIMORE

Pensionet në Kosovë – Sfidat dhe mundësitë

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Autor: Selatin Kllokoqi

Editor: Burim Ejupi

Me kontribut të: Shpresa Frrokaj

"Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme eDanimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së."

Përmbajtja

Metodologjia 4

Sistemet pensionale dhe terminologjia 4

Struktura e Mbrojtjes Sociale Para-Konfliktit 7

Pensionet pas vitit 1999 8

Shtylla e parë – Pensionet e financuara nga shteti 11

A) Pensioni bazë 12

b) Pensioni kontribuues 14

C) Pensioni e aftësisë së kufizuar të përhershme 15

D) Skema pensionale e Trepçës 16

E) Pensionet familjare 17

F) Pensioni invalidor i punës 18

Ligjet e veçanta 18

1) Skema pensionale për persona të verbër Nr. 04/L-092 19

2) Skema pensionale për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-100 19

3) Skema pensionale për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 04/L-261 .. 20

5) Ligji për vlerat e luftës Nr.04/L-054 22

6) Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetrapelgjikë. Ligji Nr.05/L-067 23

7) Ansambli Shota 23

Shqyrtim i skemave pensionale të financuara nga buxheti i shtetit 23

Shqyrtimi i Shtyllës së Dytë 25

Shembuj nga shtetet e tjera 28

Suedi 28

Slovenia 29

Krahasimet 29

Përfundimet 31

Lista e figurave

Figura 1. Llojet e ndryshme të provizioneve të pensionit 4
Figura 2. Sistemi pensional i Kosovës krahasuar me definicionin e shtyllave të BB dhe ILO 5
Figura 3. Përfitimi i përcaktuar vs Kontributi i përcaktuar 6
Figura 4. Sistemi pensional në Kosovë 2002 8
Figura 5. Skemat pensionale në Kosovë 2018 8
Figura 6. Zhvillimi i Shtyllës së Parë dhe Skemave të Veçanta Pensionale gjatë viteve, numri i skemave pensionale 9
Figura 7. Shpenzimet dhe pagesat për dy shtyllat 10
Figura 8. Shpenzimet dhe pagesat për dy shtyllat plus skemat e veçanta 10
Figura 9. Zhvillimi i Shtyllës së Parë dhe Skemave të Veçanta Pensionale gjatë viteve, numri i skemave pensionale, numri i përfituesve, pensioni mesatar 11
Figura 10. Shtylla e parë e skemave pensionale 11
Figura 11. Pensioni bazë, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 12
Figura 12. Shtetet që janë duke e implementuar pensionin universal të moshës 13
Figura 13. Shtetet që janë duke e implementuar pensionin universal të moshës 13
Figura 14. Shtetet që implementojnë pensionin "Means-tested" (i testuar) 14
Figura 15. Pensioni kontributiv, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 14
Figura 16. Hyrja në skemë e përfituesve të fundit të pensionit kontributiv 15
Figura 17. Krahasimi i të dhënave nga ASK me të dhënat nga MPMS 15
Figura 18. Pensionimi i aftësisë së kufizuar, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 15
Figura 19. Pensioni i Trepçës, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 17
Figura 20. Pensioni familjar, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 17
Figura 21. Pensioni invalidor i punës, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 18
Figura 22. Skema pensionale për personat e verbër, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 19
Figura 23. Skema pensionale për trupat mbrojtëse të Kosovës, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 19
Figura 24. Skema pensionale për veteranët, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 20
Figura 25. Skema pensionale e FSK-së, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 21
Figura 26. Skema pensionale për vlerat e luftës, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 22
Figura 27. Skema pensionale për vlerat e luftës, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve 22
Figura 28. Skema pensionale për paraplegjik dhe tetralegjik, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro 23
Figura 29. Skema pensionale për Ansamblin Shota, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro 23
Figura 30. Krahasimi i pagesave për aftësi të kufizuar me pagesën dhe shkallën e invaliditetit 25
Figura 31. Shkalla e dytë, pagesat dhe tërheqjet gjatë viteve 25
Figura 32. Pagesat në shtyllën e dytë gjatë viteve 26
Figura 34. Pagesa mesatare mujore ndër vite 27
Figura 35. Sistemi pensional në Suedi 28
Figura 36. Sistemi pensional në Slloveni ..... **Error! Bookmark not defined.**
Figura 37. Prirjet për shpenzim të buxhetit për pensione. Burimi: Gazeta e RKS 30

Metodologjia

Qëllimi i këtij studimi është analiza e sistemit pensional të Kosovës, krahasimi i përvojës së Kosovës me vendet që kanë një histori të dëshmuar dhe identifikimin e sfidave para reformës së planifikuar të pensioneve.

Gjetjet e këtij studimi bazohen kryesisht në mbledhjen dhe analizimin e informatave që janë të qasshme, të dhënat e ndryshme nga institucionet qeveritare, artikujve relevant që gjinden online, ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme, raporteve nga organizatat e ndryshme dhe informatave të tjera në dispozicion.

Krahasimi u fokusua në Suedi dhe Slloveni me idenë e nxjerrjes së mësimeve nga praktikat më të mira të tyre në skemat përkatëse të pensioneve. Suedia, si një nga vendet me standardet më të mira të jetesës dhe udhëheqës i shtetit të mirëqenies dhe Sllovenia, si shembull i një vendi të suksesshëm në zhvillim pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë.

Sistemet pensionale dhe terminologjia

Plakja e popullsisë është bërë një nga faktorët që përcakton planet dhe nismat e reformës së pensioneve. Raporti i Parlamentit të BE-së konstaton se "... ndryshimi demografik po ushtron presion mbi elementet e sistemeve të pensioneve të financuara nga shteti (PAYG), të cilat janë pjesë thelbësore e çdo sistemi pensionesh në BE[1]". Vetëm sistemi gjeneratë për gjeneratë (PAYG)në terma afatgjatë nuk po mund t'i plotësojë nevojat e njerëzve të moshuar e as të shtetit. Ndonëse kjo është bërë e qartë dhe e parashikueshme, shtete të ndryshme kanë filluar reformat e sistemit të pensioneve të cilat janë në përputhje me këto zhvillime, si dhe zhvillime të tjera që lidhen me zhvillimet ekonomike në nivel global. Sistemet e pensioneve në përgjithësi kategorizohen në tri shtylla ose nivele, ku financimi shtesë paraqitet së bashku me sistemin PAYG.



BankaBotërore (BB)kategorizimin e sistemeve pensionale e ndanë kryesisht në tri shtylla:

• Shtylla e parë: relativisht e vogël, që administrohet publikisht, PAYG, shtylla e përfitimit të përcaktuar.

• Shtylla e dytë: e menaxhuar privatisht, e detyrueshme (kontribut i përcaktuar);

Figura 1. Llojet e ndryshme të provizioneve të pensionit

[1] European Parliament (2014), Directorate General for Internal Policies, Policy Department A, Economic and Scientific Policy. Pension schemes, Page 9, Brussels.

• Shtylla e tretë: llogaria vullnetare, individuale, shtyllë e menaxhuar privatisht.[2]

Kategorizimi sipasOrganizatës ndërkombëtare të punës (ILO) është si më poshtë:
• Një pension minimal anti-varfëri, i qasshëm për të gjithë por i testueshëm (means-tested), potencialisht i financuar drejtpërdrejtë nga të ardhurat e përgjithshme dhe të indeksuara;
• Një pension sigurimi shoqëror publik i detyrueshëm PAYG, i cili do të siguronte një shkallë të arsyeshme zëvendësimi. Do të ishte plotësisht i indeksuar kundrejt inflacionit. Dhe do të kishte një lartësi maksimale;
• Një skemë me financim të plotë me kontribute të përcaktuara,me gjasëe menaxhuar privatisht, e cila do ta plotësonte skemën publike. Kjo do të përfshinte skema profesionale si dhe individuale. Veprimi i tyre do të duhej të monitorohej dhe të rregullohej nga afër.[3]Kategorizimi nga BB dhe ILO ndryshon gjithashtu nga kategorizimi i bërë nga vendet e OECD. Në përgjithësi, ka pak komponente kryesore të sistemeve të pensioneve që janë brenda këtyre tri shtyllave edhe pse mund të gjenden në shtylla të ndryshme, varësisht nga institucioni ku po i referohemi.

Sistemi pensional i BB/Sistemi pensional i Kosovës				
	Shtylla zero	**Shtylla I**	**Shtylla II**	**Shtylla III**
	Pensioni universal	**PAYG, DB**	**Kontribut i definuar**	**Në baza vullnetare**
WB pension system	Shtylla zero i referohet përfitimeve të pensioneve të siguruara pasur nevojë për të paguar kontribut. Këto financohen nga të ardhurat e përgjithshme.	Shtylla e parë i referohet pensioneve ku kualifikimi varet nga personi që ka dhënë kontribute gjatë jetës së tij ose të saj në punë. DB, PAYG.	Shtylla e dytë i referohet sistemeve obligative të kontributeve të përcaktuara ku individët i japin kontributet e tyre në llogaritë e kursimeve të institucionet financiare, zakonisht fondet e specializuara të pensioneve.	Shtylla e tretë është pothuajse identike me shtyllën e dytë, por kursimet bëhen në baza vullnetare dhe jo të detyrueshme.
Sistemi pensional i Kosovës	Pensioni bazë	Asnjë	Fondi pensional i Kosovës, TRUST	**Në baza vullnetare**
Sistemi pensional i ILO/Sistemi pensional i Kosovës				
		Shtylla I	**Shtylla II**	**Shtylla III**
Sistemi pensional i ILO		Një pension minimal kundër varfërisë, i disponueshëm për të gjithë, por means-tested, me gjasë i financuar drejtpërdrejtë nga të ardhurat e përgjithshme dhe të indeksuara.	Një pension sigurimi social publik PAYG i detyrueshëm i cili do të siguronte një shkallë të arsyeshme zëvendësimi. Do të ishte plotësisht i indeksuar kundrejt inflacionit.	Një skemë e financuar plotësisht me kontribute të përcaktuara, mbase privatisht e menaxhuar, e cila do të plotësonte skemën publike.
Sistemi pensional i Kosovës		Pensioni bazik	Asnjë	Fondi pensional i Kosovës, TRUST

Figura 2. Sistemi pensional i Kosovës krahasuar me definicionin e shtyllave të BB dhe ILO

Përkufizimet e BB-së në shtyllat e pensionit e njohin edhe Shtyllën Zero e cila "i referohet përfitimeve të pensioneve të siguruara pa paguar kontribute"[4]. Në anën tjetër, BB e vendos Pensionin Bazë në shtyllën e parë me anë të së cilës pensioni bazë nënkupton pensionin për "... të gjithë ata që kanë përmbushur kërkesat minimale tëpërvojës së punës marrin një përfitim të sheshtë që nuk ndërlidhet me pagat ose vlerën e kontributeve të tyre. Përfitimi mund të ndryshojë në varësi të përvojës së punës. Pas

[2]Yermo Juan (2002), Revised Taxonomy for Pension Plans, Pension Funds and Pension Entities, Page 17.
[3]ibid.
[4]Schwarz M. Anita and Arias S. Omar (2014). The Inverting Pyramid, Pension Systems Facing Demographic Challenges in Europe and Central Asia. Page 35, The World Bank, Washington DC.

daljes në pension, përfitimet zakonisht indeksohen me disa parametra "[5].

Përfitim i përcaktuar	VS	Kontribut i përcaktuar
Krahasimi i 2 planeve pensionale		
Të ardhurat e pensionit të garantuara për jetë		Të ardhurat e pensionit të pa garantuara për jetë
Punëdhënësi përgjegjës për investimin e kontributeve		Punëmarrësi përgjegjës për investimin e kontributeve
Shuma e të ardhurave të pensionit dihet		Shuma e të ardhurave të pensionit nuk dihet
Mbrojtja ndaj inflacionit dhe përfitimet e mbijetesës zakonisht ndërtohen		Mbrojtja ndaj inflacionit dhe përfitimet e mbijetesës nuk ndërtohen

Figura 3. Përfitimi i përcaktuar vs Kontributi i përcaktuar

Sistemet e pensioneve mund të dallohen gjithashtu sipas mënyrës së llogaritjes së përfitimeve dhe nëse ato financohen apo jo. Përfitimet mund të përcaktohen me një formulë (*në sistemet me përfitime të përcaktuara*), ose bazuar në kontributet që investohen në tregjet financiare dhe prodhojnë kthim të investimeve (*në sistemet me kontribute të përcaktuara*). Sipas mekanizmit të përfitimeve të përcaktuara, pensioni i marrë zakonisht është funksion i të ardhurave të shprehura si përqindje e të ardhurave në vit të kontributit; mund të definohet edhe në ndonjë mënyrë tjetër. Dallimi është se përfitimi i siguruar është i specifikuar në një farë mënyre. Nëse financimi bie, dikush, zakonisht, ose qeveria në një plan publik ose punëdhënësi në një plan të bazuar në punëdhënës, ka përgjegjësinë të sigurojë pensionin.

Në mënyrë alternative, sipas mekanizmit të kontributeve të përcaktuara, kontributi specifikohet si përqindje e pagave dhe normat përcaktohen për punonjësit, punëdhënësit dhe potencialisht qeverinë, por pensioni përfundimtar përcaktohet nga shuma ekzistuese në llogarinë e pensionit të individit në kohën e daljes në pension, e cila përfshin si kontributet ashtu edhe të ardhurat e investimeve në ato kontribute. Nën këtë sistem nuk premtohet një përfitim i veçantë; pensioni varet plotësisht nga paratë në llogari dhe nuk ka nevojë për një garantues të fundit[6]. Sistemet e pensioneve ose para-financohen (shpesh quhen plotësisht të financuara ose vetëm të financuara), me kontributin e individëve të investuar për të paguar përfitimet e veta të ardhshme ose gjeneratë për gjeneratë (PAYG), ku pensionistët aktualë paguhen nga kontributet aktuale dhe secili brez varet nga brezi i ri për të paguar për pensionet e tyre. Sistemi i pensioneve të shtetit të ish RJ-së, në të cilën bënte pjesë Kosova, ishte gjeneratë për gjeneratë, e detyrueshme. Këto sisteme vendosin pensionet bazuar në formula që i lidhnin pensionet me historinë e pagave të kaluaratë një personi.

Pensionet e PAYG mund të bazohen në kontributet e përcaktuara me notë (NDC), në të cilat formula e përfitimit varet jo vetëm nga historia e pagave të një personi, por edhe nga një normë interesi imagjinare që lidhet me rritjen e pagave (dhe punësimit) në ekonomi. Një lloj i tretë i sistemit PAYG është *një sistem me pika*, në të cilin pensionet bazohen në rrjedhjen e pikëve në karrierën e punës. Një sistem i tillë ka më pak rishpërndarje sesa sistemet e tjera të DB.
Reformat parametrike janë reformat e futura në një sistem PAYG për të ndryshuar normat e kontributeve, formulat e përfitimit dhe parametrat e tjerë pa ndonjë reformë më të madhe sistemore, si futja e fondeve. Duke shkuar përtej masave të tilla, një numër vendesh kanë reformuar

[5]ibid, faqe 36.
[6]Schwartz, Anita M.(2006) Pension system reforms (English). Social Protection discussion paper series ; no. SP 0608. Washington, DC: World Bank. http://documents.worldbank.org/curated/en/468421468166155721/Pension-system-reforms.

sistemet e tyre për të përfshirë një kursim të financuar nga kontributet e përcaktuara në baza individuale. Brenda këtyre kategorive të përgjithshme mund të bëhen një numër i pafund kombinimesh. Të gjitha sistemet kanë avantazhe dhe disavantazhe e veta, me shkallë dhe lloje të ndryshme të rrezikut.

Struktura e Mbrojtjes Sociale Para-Konfliktit

Para vitit 1989, Kosova ishte e mbuluar nga sistemi i pensioneve jugosllave. Ky ishte një sistem gjeneratë për gjeneratë (PAYG) në të cilin punonjësit ekzistues kontribuonin në fondin e pensioneve dhe ato kontribute përdoreshin për t'ua paguar përfitimet pensionistëve ekzistues.

Nivelet e pensioneve u përcaktuan nga një formulë përfitimesh bazuar në vitet e shërbimit dhe nivelin e pagës. Deri në vitin 1989, Kosova kishte fondin e vet pensional që mblodhi kontribute dhe pagoi përfitime. Në vitin 1989, këto funksione u centralizuan në Beograd dhe fondi i Kosovës u shpërbë.
Midis viteve 1970 dhe 1989, Kosova funksionoi në sistemin e vet të mbrojtjes sociale nën legjislacionin e legjislaturës të krahinës autonome kosovare. Kjo ishte në përputhje me dhe nën ombrellën e përgjithshme të legjislacionit federal jugosllav. Transferet e parave përfshinin pensionet kontribuuese dhe përfitimet e papunësisë, ndihmat për fëmijëve për kontribuuesitme paga të ulëta dhe ndihmë sociale shumë të kontrolluar për familjet pa burime të ardhurash. Në vitin 1989, legjislacioni kosovar u zëvendësua dhe të gjitha të drejtat dhe programet u përfshinë direkt në sistemin serb të mbrojtjes sociale dhe u drejtuan nga Beogradi.

Skema e pensioneve, e cila përfshinte pensionet e moshës (me një numër të dispozitave të pensionit të parakohshëm), pensionet e invaliditetit dhe mbijetesës, si dhe pagesat për aftësi të kufizuar. Në praktikë, vetëm një pjesë relativisht e vogël e popullsisë ishte në skemë, pothuajse të gjithë të punësuar në sektorin shtetëror. Kjo ishte pjesërisht pasqyrim i sistemit të ish-Jugosllavisë, i cili është thjesht program sigurimi social dhe për të cilin pjesëmarrja për fermerët është iniciuar vetëm në vitet 1970.

Përfitimi për papunësi, i cili ishte i bazuar në të dhënat e kontributeve dhe mjeteve të testuara. Programi u administrua nga Shërbimi i Punësimit përmes një rrjeti rajonal, i cili gjithashtu drejtonte një gamë të programeve aktive të tregut të punës.

Ndihmat për fëmijët u paguan në bazë të **mjeteve të testuara** për njerëzit me punë me të ardhura të ulëta. Pagesat të ndihmës sociale u konsideruan qartazi si mjet i fundit, duke bartur shkallë të lartë të stigmës. Këto janë dhënë edhe në baza të rregullta edhe si ndihmesë qëjepej vetëm njëherë për ata që përjetonin vështirësi të përkohshme. Pagesat u synuan sipas mjeteve dhe me theks të veçantë tek ata që nuk ishin në gjendje të punonin. Këto përfitime dhe shërbime të tjera sociale u administruan përmes një rrjeti rajonal të Qendrave për Punë Sociale (QPS) të ngjashme me ato që gjendeshin në ish-Jugosllavi.

Të gjitha aspektete sistemitfinancoheshin nga kontributet e paguara nga punëdhënësit dhe punonjësit. Në praktikë, këto të fundit ishin kryesisht kombëtare. Të gjitha pagat u vendosën në

aspektin e pagës neto. Kontributet e ndryshme u llogaritën si një përqindje e kësaj pagese neto, e cila vetë nuk mbeti e ndikuar nga ndryshimet në normën e kontributit. Përveç kësaj, mbrojtja sociale u subvencionua nga buxheti deri në një farë mase, duke përfshirë fondet nga Fondi për Rajonet e pazhvilluara, një fond Jugosllav i cili shpërndau burime nga rajonet më të pasura në ato më të varfra dhe nga të cilat Kosova duhet të kishte qenë përfitues kryesor.

Pensionet pas vitit 1999

Pas përfundimit të konfliktit, UNMIK-u filloi një program të ndihmës sociale që përfshinte pagesat për kategori të caktuara të të moshuarve në bazë të nevojës. Këto pagesa për të moshuarit nuk mbulonin një pjesë të madhe të popullatës së vjetër, kryesisht nuk shkonin tek ata që kishin dhënë kontribute në të kaluarën dhe shiheshin si ndihmesa sociale në vend të përfitimeve të pensioneve. Ndërmjet viteve 1999-2002 nuk kishte asnjë pension të paguar.

Sistemi pensional në Kosovë 2002		
Shtylla I	Shtylla II	Shtylla III
E financuar nga shteti	E detyrueshme	Vullnetare
Pensioni Bazë		
Pensioni i aftësisë së kufizuar		

Figura 4. Sistemi pensional në Kosovë 2002

Më 2002, në Kosovë u hartua dhe filloi se implementuari një sistem thelbësisht i ri i pensioneve. Sistemi përbëhet nga tri komponentë apo "shtylla". Shtylla I përbëhet prej një "pensioni bazë" (të paguar për të gjithë kosovarët, 65 vjeç dhe më të vjetër, banorë të përhershëm të Kosovës, shtetësi kosovare) dhe një pension invalidor, të dyja këto financuara nga buxheti i shtetit. Shtylla II e sistemit pensional është një program pensional i kursimeve, i detyrueshëm, me kontribut të përcaktuar. Programi kërkon që të gjithë banorët e përhershëm të Kosovës që janë të punësuar të kontribuojnë me 5% të pagës bruto që bashkohet me një kontribut prej 5% të punëdhënësit. Shtylla III e sistemit parashikon pension shtesë, individual ose të sponsorizuar nga punëdhënësi, kjo skemë pensionesh është në baza vullnetare.Sistemi i ri i pensioneve nuk kishte asgjë të përbashkët me sistemin e mëparshëm të pensioneve në Kosovë. Gjithçka filloi nga zero, nuk kishte vazhdimësi me sistemin e vjetër.

Sistemi dhe skemat pensionale në Kosovë 2018			
Shtylla I	**Shtylla II**	**Shtylla III**	**Ligjet e veçanta**
Të financuara nga shteti	E detyrueshme	Vullnetare	Të financuara nga shteti
Bazik	65+		TMK
I aftësisë së kufizuar	Invaliditeti		FSK
Kontribues			Me shikim të dëmtuar
Pasaftësi për punë			Tetraplegjik and paraplegjik
Trepça			Veteranët e luftës
			Ansambli Shota

Figura 5. Skemat pensionale në Kosovë 2018

Sistemi i sotëm i pensioneve në Kosovë ka rregullim të ngjashëm, ka ende tre shtylla, por me numër shtesë të ligjeve të veçanta për kategori të caktuara të cilat financohen nga buxheti i shtetit.

Shtylla e parë e sistemit të pensioneve të Kosovës, financohet plotësisht nga shteti dhe mbulon të gjitha kategoritë e pensioneve në Kosovë, duke përfshirë pensionin bazë të pleqërisë, pensionet e përhershme të aftësisë së kufizuar, pensionin kontribuues, pensionin familjar, pensionin invalidor të punës dhe pensionet e parakohshme të ish minatorëve (Pensioni i Trepçës) . Megjithëse skemat e pensioneve të veçanta menaxhohen nga e njëjta ministri si pensionet nga shtylla e parë, ato rregullohen me ligje të veçanta dhe financohen plotësisht nga buxheti i shtetit. Për dallim me Kosovën, në BE "*në vitin 2015*[7]*, dy burimet kryesore të financimit të mbrojtjes sociale në nivel të BE-së ishin kontributet sociale, që përbëjnë 54% të të ardhurave totale dhe kontributet e përgjithshme të qeverisë nga taksat që arrijnë në 43%*".Këto skema të veçanta të pensioneve janë futur në kohë të ndryshme përmes qeverive të ndryshme, por kryesisht bazuar në zgjedhjet e politikave[8]; interesat afatshkurtra të elitës qeverisëse, premtimeve të zgjedhjeve dhe bazohen në lobimet e grupeve të ndryshme. Nëse këto tendenca të miratimit të ligjeve të veçanta vazhdojnë, Kosova do të ketë skema pensionale për çdo grup njerëzish që mendon se meritojnë pension, janë të fuqishëm në lobim dhe e gjejnë momentin

Zhvillimi i Shtyllës së Parë dhe Skemave të Veçanta Pensionale gjatë viteve, numri i skemave pensionale									
Viti	**Dec-10**	**Dec-11**	**Dec-12**	**Dec-13**	**Dec-14**	**Dec-15**	**Dec-16**	**Dec-17**	**Apr-18**
Shtylla e parë	Bazik	Bazik	Bazik	Bazik	Bazik	Bazik	Bazik	Bazik	Bazik
	I aftësisë së kufizuar	I aftësisë së kufizuar	I aftësisë së kufizuar	I aftësisë së ku	kufizuar	I aftësisë së kufizuar	I aftësisë së kufizuar	I aftësisë së kufizuar	I aftësisë së kufizuar
	Kontribues	Kontribues	Kontribues	Kontribues	Kontribues	Kontribues	Kontribues	Kontribues	Kontribues
	Trepca	Trepca	Trepca	Trepca	Trepca	Trepca	Trepca	Trepca	Trepca
									Familjar
									Invaliditetit në punë
Nr. I Sk. Pens.	4	4	4	4	4	4	4	4	6
Skemat e veçanta	Vlerat e Luftës	Vlerat e Luftë	Vlerat e Luftë	Vlerat e Luftë	Vlerat e Luftë	Vlerat e Luftë	Vlerat e Luftë	Vlerat e Luftë	Vlerat e Luftës
	TMK	TMK	TMK	TMK	TMK	TMK	TMK	TMK	TMK
			KSF	KSF	KSF	KSF	KSF	KSF	KSF
					Personat e ver	Personat e ver	Personat e ver	Personat e ver	Personat e verbër
						Veteranët	Veteranët	Veteranët	Veteranët
									Tetraplegjik paraplegjik
Nr. I Sk. Pens.	2	2	3	3	4	5	5	5	6

Figura 6. Zhvillimi i Shtyllës së Parë dhe Skemave të Veçanta Pensionale gjatë viteve, numri i skemave pensionale

e duhur për politikanët për të mbështetur çështjen e tyre, për shembull përpara zgjedhjeve.Me ligje të veçanta rregullohen pensionet për personat me shiqim të dëmtuar, pensionet për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pensionet për personat me vlera të luftës, pensionet e veteranëve të luftës, pensionin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (këtu e tutje TMK), pensionin e Forcat e Sigurisë së Kosovës (këtu e tutje si FSK), dhe pensionet e Ansamblit "Shota". Këto skema pensionale financohen plotësisht nga të ardhurat e shtetit. Në vitin 2002, kur u fut sistemi i ri i pensioneve, shtylla e parë kishte vetëm dy skema, tani në 2018 shtylla e parë ka 6 skema plus 6 skema pensionale të përcaktuara me ligje të veçanta, gjithsej 12 skema që janë 100% të financuara nga buxheti i shtetit, tendenca po rritet.

Shtylla e dytë është e detyrueshme e bazuar në kontribut. Punonjësi dhe punëdhënësi kontribuojnë me çdo 5% të pagës; kjo është minimumi i detyrueshëm që duhet të paguhet në fondin e pensionit nga secili punonjës. Në baza vullnetare: "... punëdhënësit mund të kontribuojnë vullnetarisht një shumë shtesë deri në total prej dhjetë për qind (10%) të pagës mujore, për një maksimum total prej pesëmbëdhjetë për qind (15%) të pagës. Punonjësit gjithashtu mund të kontribuojnë

[7]Eurostat News Release (2017), Social protection in 2015 Almost one-third of EU GDP spent on social protection, 188/2017, 8 December.

[8]International Bank for Reconstruction and Development/ The World Bank 2017), Social protection and health expenditure note Kosovo, January.

vullnetarisht një shumë shtesë deri në total prej dhjetë për qind (10%) të pagës së tyre vjetore, për kontribut maksimal prej pesëmbëdhjetë për qind (15%) të pagës ... ".[9]
Të gjithë ata që marrin pensione nga shtylla e dytë mund të marrin ndonjë pension nga shtylla e parë ose nga skema speciale nëse plotësojnë kushtet përkatëse. Në praktikë çdo person që merr pension nga shtylla e dytë merr të paktën një pension (pensionin bazë) nga shtylla e parë me mundësi për të marrë pensione të tjera nga skemat e veçanta.

Shtylla e tretë mbetet skemë vullnetare, e plotësuar ose nga punëdhënësi ose punonjësi, ose të dytë në të njëjtën kohë. Sipas sigurimit kolektiv plotësues të pensionit, parashikohet lehtësimi i taksave për punëdhënësit si dhe punonjësit. Përveç kësaj, sigurimi i pensioneve mund të përdoret si mjet nxitës për punonjësit; kjo mund të integrohet në bonusin e punëdhënësit, dhe gjithashtu të konsiderohet si shtesë e pagës së punonjësve.

Shpenzimet dhe pagesat për dy shtyllat		
Viti	Shtylla I	Shtylla II
2012	€ 158,103,474.00	€ 8,700,000.0
2013	€ 186,532,981.00	€ 10,700,000.0
2014	€ 235,025,738.00	€ 14,300,000.0
2015	€ 263,218,145.00	€ 19,300,000.0
2016	€ 321,226,929.82	€ 19,200,000.0
2017	€ 338,776,663.26	€ 27,440,000.0

Figura 7. Shpenzimet dhe pagesat për dy shtyllat

Këto tri shtylla ndryshojnë në lidhje me madhësinë, burimin e financimit dhe nganjëherë edhe me grupin e synuar. Megjithatë, shtylla e parë mbetet shtylla kryesore e sistemit të pensioneve kosovare. Për shkak se mbulon pothuajse të gjitha pensionet, kjo shtyllë do të jetë fokusi i këtij punimi. Sa për krahasim, në figurën 7 janë paraqitur kostot e shtyllës së parë dhe së dytë, praktikisht se çka mbulon shteti dhe çka mbulohet përmes kontributit vetanak.

Shpenzimet dhe pagesat për dy shtyllat plus skemat e veçanta			
Viti	Shtylla I	Shtylla II	Skemat e veçanta
2012	€ 125,997,161.00	€ 8,700,000.0	€ 32,106,313.00
2013	€ 154,083,449.00	€ 10,700,000.0	€ 32,449,532.00
2014	€ 190,959,213.00	€ 14,300,000.0	€ 44,066,525.00
2015	€ 211,339,320.00	€ 19,300,000.0	€ 51,878,825.00
2016	€ 227,375,227.00	€ 19,200,000.0	€ 93,851,702.82
2017	€ 226,829,937.00	€ 27,440,000.0	€ 111,946,726.26

Figura 8. Shpenzimet dhe pagesat për dy shtyllat plus skemat e veçanta

Figura 8 tregon kostot e shtyllës së parë të financuara nga shteti, shtylla e dytë nga kontributet dhe skemat e pensioneve të veçanta të financuara nga shteti.Siç tregojnë këto dy figura, mbetet sfidë për të ardhmen që buxheti i Kosovës ta financojë shtyllën e parë.

Nëse trendi i vitit të kaluar vazhdon, atëherë në terma afatgjatë, buxheti i Kosovës do të ketë vështirësi në financimin e shtyllës së parë. Figura më poshtë tregon numrin e skemave të pensioneve; se si janë rritur që nga viti 2010 duke i përfshirë kostot për buxhetin e Kosovës. Skemat e reja të pensioneve janë në pritje; si ajo e arsimit, policisë dhe shumë skema të tjera pensionale të këtij lloji. Nëse tendenca vazhdon dhe nuk do të ketë reforma pensionale, atëherë brenda pak vitesh Kosova do të përfundojë me më shumë se 20 skema pensionale.

[9]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2012), Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Koosvës, Neni 6, Paragrafi 6.2, c, 6 Prill, Prishtinë

Zhvillimi i Shtyllës së Parë dhe Skemave të Veçanta Pensionale gjatë viteve, numri i skemave pensionale, numri i përfituesve, pensioni mesatar									
Viti	Dec-10	Dec-11	Dec-12	Dec-13	Dec-14	Dec-15	Dec-16	Dec-17	Dec-18
Shtylla e parë	€ 108,459,365.00	€ 107,073,630.00	€ 125,997,161.00	€ 154,083,449.00	€ 190,959,213.00	€ 211,339,320.00	€ 227,375,227.00	€ 226,829,937.00	
	163,636	162,250	170,155	174,550	186,432	194,638	184,574	188,729	
	€ 55.2	€ 55.0	€ 61.7	€ 73.6	€ 85.4	€ 90.5	€ 102.7	€ 100.2	#DIV/0!
Nr. I skemave pensionale	4	4	4	4	4	4	4	4	6
Skemat e veçanta	€ 24,410,137.00	€ 30,350,646.00	€ 32,106,313.00	€ 32,449,532.00	€ 44,066,525.00	€ 51,878,825.00	€ 93,851,702.82	€ 111,946,726.26	
	13,552	13,764	14,024	14,102	17,219	35,026	45,664	51,794	
	€ 150.1	€ 183.8	€ 190.8	€ 191.8	€ 213.3	€ 123.4	€ 171.3	€ 180.1	#DIV/0!
Nr. I skemave pensionale	2	2	3	3	4	5	5	5	6
Shtylla e parë plus skemat e veçanta	€ 137,424,276.00	€ 137,424,276.00	€ 158,103,474.00	€ 186,532,981.00	€ 235,025,738.00	€ 263,218,145.00	€ 321,226,929.82	€ 338,776,663.26	€ -
	177,188	176,014	184,179	188,652	203,651	229,664	230,238	240,523	-
	€ 64.63	€ 65.06	€ 71.54	€ 82.40	€ 96.17	€ 95.51	€ 116.27	€ 117.38	#DIV/0!
Nr. I skemave pensionale	6	6	7	7	8	9	9	9	12

Figura 9. Zhvillimi i Shtyllës së Parë dhe Skemave të Veçanta Pensionale gjatë viteve, numri i skemave pensionale, numri i përfituesve, pensioni mesatar

Shtylla e parë – Pensionet e financuara nga shteti

Pensionet nga shtylla e parë së bashku me skemat e pensioneve të veçanta në Kosovë përbëjnë pjesën më të madhe të sistemit të pensioneve. Këto janë pensione të financuara nga shteti të cilat

Shtylla e parë						
Kategoria	Bazik	Kontribues	Familjar	Paaftësia e përhershme	Paaftësia për punë	Pensioni i parakohshëm i
Kriteri kryesor për përfituesin	Mosha 65+,Banor i përhershëm i Kosovës, nënshtetësia e Kosovës	Mosha 65+,Banor i përhershëm i Kosovës, së paku 15 vite kontributi para vitit 1999	Individët që kanë marrë pension familjar para vitit 1999. Familjet e individit që vdes dhe i cili ka qenë i siguruar dhe ka kontribuuar në sistemin pensional për së paku 15 vite para 1999	Mosha 18-65, paaftësi e përhershme 100%, banor i përhershëm i Kosovës	Individët nën moshën 65 që kanë marrë pension të njëjtë para vitit 1999, personat që janë lënduar gjatë punës dhe si rezultat kanë paaftësi të përhershme 100%	Mosha 50-65, banor i përhershëm i Kosovës, së paku 10 vite kontribut në sektorin minerar deri në vitin 2004, 50% paaftësi për punë, nuk duhet të ketë të ardhura të tjera apo të jetë i vetëpunësuar
Shuma	€ 75	€ 158	€ 75	€ 75	€ 75	€ 105
		€ 172				
		€ 186				
		€ 230				

Figura 10. Shtylla e parë e skemave pensionale

janë në dispozicion të secilit qytetar të Kosovës, nëse plotësojnë kushtet e parapara në përputhje me ligjet që garantojnë këto pensione. Mbulimi i personave mbi 65 vjeç është 100% me një lloj të pensionit, mbulimi para luftës nuk ka qenë kurrë mbi 50%.Pensionet e shtyllës së parë mbulohen kryesisht nga ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti Nr. 04 / L-131. Tabela më lartë shpjegon kushtet kryesore që përfituesit duhet të përmbushin për të marrë ndonjë nga këto pensione. Sipas këtij ligji, neni 16, përfituesit e secilit prej këtyre pensioneve nuk mund të marrin ndonjë pension tjetër të rregulluar nga ky ligj ose ndonjë pension tjetër nga skemat e pensioneve të veçanta që menaxhohen dhe administrohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Edhe pse kjo është shumë e qartë e përcaktuar në këtë ligj dhe në disa ligje të tjera, ka disa ligje të veçanta që nuk e përmendin atë. Përderisa kjo nuk përmendet në çdo ligj, shumë individë kanë marrë më shumë se një pension nga skema të ndryshme sidomos deri në vitin 2016. Në vitin 2016, mijëra individë që merrnin dy ose më shumë pensione u përjashtuan nga kjo mundësi, ata duhej të

zgjidhnin për një pension dhe shumica zgjodhën pensionin më të lartë. Prej gjashtë skemave të pensioneve që mbulohen me këtë ligj, pensionet e familjes dhe të paaftësisë për punë kanë filluar të zbatohen në vitin 2018.

A) Pensioni bazë

Përfituesit e pensionit bazë në Kosovë janë të gjithë personat "... të cilët janë shtetas të përhershëm të Republikës së Kosovës, të cilët posedojnë dokumente identifikimi dhe që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare"[10]. Çdo kosovar që i përmbush këto tri kritere kryesore, pa marrë parasysh nëse ai ka punuar ndonjëherë ose ka kontribuar në ndonjë skemë pensionale, do të marrë këtë pension. Këto kritere janë që nga viti 2002, në atë kohë kjo ishte skema e vetme e pensioneve së bashku me pensionin e aftësisë së kufizuar. Sipas këtyre kritereve të gjithë personat mbi 65 vjeç u mbuluan, askush nuk u la jashtë skemës pensionale. Pas 15 vjetësh, sistemi i pensioneve në Kosovë ka ndryshuar, tani janë në implementim 12 skema pensionale me mbi 20 kategori te ndryshme përfituesish. Situata në terren ka ndryshuar; faza emergjente që ishte e pranishme pas luftës në vitin 1999 nuk është më prezente.

	Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti Ligji Nr. 04/L-131			
Kriteri kryesor për përfituesin	1) Mosha 65+ 2) Banor i përhershëm i Kosovës 3)Nënshtetësi Kosovare			
Shuma	€ 75.00			
Viti	2014	2015	2016	2017
Benefitet	125,883	132,000	120,014	122,716
Shuma	€ 108,312,220.00	€ 120,456,558.00	€ 117,600,660.00	€ 113,079,075.00

Figura 11. Pensioni bazë, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

Tani shumica e pensionistëve mbi moshën 65 vjeçare janë në dy skema, pension bazë dhe kontribuues. Numri i përfituesve të pensionit bazë ka pësuar dy ndryshime të mëdha gjatë viteve, së pari me futjen e pensionit kontribuues dhe ndryshimi i dytë i madh ka qenë në vitin 2016. Në dhjetor 2015, MPMS ka miratuar Udhëzimin Administrativ 07/2015, ku aplikantët e rinj dhe tashmë përfitues të pensioni bazë duhej të provonin se janë banorë të përhershëm të Kosovës, shumë prej tyre nuk mund ta vërtetonin. Gjithashtu në vitin 2016, Neni 16 i Ligjit Nr. 04 / L-131 u zbatua në mënyrë më strikte, zbatimi i të cilit çoi në ndalimin e pensionit për mijëra përfitues të pensioneve të cilët kanë marrë më shumë se një pension. Neni 16 përcakton që "Personat që përfitojnë ndonjë pension të skemave të pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, në asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e pensioneve të veçanta që menaxhohen dhe administrohen nga Ministria".
Sipas këtij neni, ata që marrin pension bazë mund të marrin pension tjetër vetëm nga jashtë ose nga shtylla e dytë, por në asnjë rrethanë nuk mund të marrin pension tjetër nga buxheti i Kosovës që administrohet nga MPMS. Kjo situatë nganjëherë quhet paradoksale dhe nganjëherë edhe diskriminuese, përderisa kosovarët të cilët kohët e fundit janë kthyer në Kosovë nga jashtë edhe pse marrin një pension shumë të mirë nga vendi pritës, ata ende marrin pension bazë, ndërkaq kosovarët që jetonin në Kosovë mund të marrin vetëm një pension.

[10]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji Nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, Neni 7 Paragrafi 1, 6 maj Prishtinë.

Pensioni universal zbatohet ndryshe në vende të ndryshme. Qëllimi përfundimtar i pensionit universal është të sigurojë që secili mbi një moshë të caktuar (mosha e pensionit, në shumicën e vendeve 65+) merr një pension; askush nuk duhet të lihet pa asnjë të ardhur në moshën e daljes në pension. Kjo zbatohet ndryshe, disa vende ua japin këtë pension të gjithëve mbi moshën 65 vjeçare dhe disa vende të tjera vetëm për ata që nuk kanë pension tjetër ose të ardhura. Kohët e fundit kemi një shembull në rajon që ka filluar të japë pension social nën kritere të caktuara; Shqipëria miratoi rregulloren për pensionin social[11] ku duhet të plotësohen kushte të caktuara për ta marrë atë, siç janë; mosha 70+, të paktën pesë vitet e fundit të kenë jetuar në Shqipëri, nuk ka pension tjetër, asnjë të ardhur tjetër etj.

Në përgjithësi janë tri forma të pensioneve universale[12] që përdoren dhe zbatohen nga vende të ndryshme në botë. Sipas Pension Watch, pensionet universale të "moshës"[13] janë ato ku përshtatshmëria bazohet vetëm në moshën e individit dhe historinë e shtetësisë / rezidencës.

Pensioni universal i moshës			
Bolivia	Botswana	Brunei Darussalem	Cook Islands
Guyana	Kiribati	Kosovo	Mauritius
Namibia	Netherlands	New Zealand	Samoa
Suriname	Timor-Leste	Seychelles	

Figura 12. Shtetet që janë duke e implementuar pensionin universal të moshës

Vetëm 15 vende në botë midis tyre Holanda dhe Kosova në Evropë po zbatojnë këtë lloj të pensionit. Megjithëse Kosova është në këtë grup, realiteti tregon se Kosova është në mes të grupit të parë dhe të dytë duke pasur parasysh nenin 16 të Ligjit nr. 04 / L-131 që redukton pensionin bazë vetëm për ata që nuk marrin pension tjetër nga buxheti i Kosovës. Pensioni bazë i Kosovës është më shumë pension i testuar, edhe pse jo plotësisht, pensionet nga jashtë nuk janë të përmendura në ligj.

Pensioni minimal universal					
Armenia	Azerbaijan	Bahamas	Barbados	Belarus	Kyrgyzstan
Bermuda	Cyprus	Estonia	Finland	Kazakhstan	Latvia
Moldova	Nepal	Panama	St Vincent*	Swaziland	Lesotho
Sweden	Switzerland	Thailand	Turkmenistan	Vietnam	Lithuania
					Maldives

Figura 13. Shtetet që janë duke e implementuar pensionin universal të moshës

Një pension minimum universal[14] është ai që në mënyrë efektive siguron që çdo person mbi një moshë të caktuar të marrë një pension. Megjithatë, ata kanë një "pension-test", i cili përjashton individët të cilët kanë ndonjë formë tjetër të pensionit (shpesh në rritje). Të paktën 25 vende kanë këtë lloj të pensionit.

[11]Instituti i Sigurimeve Shoqerore te Shqiperise, Manuali, http://www.issh.gov.al/al/wp-content/uploads/2014/02/Manual_-Perfitime_2017.pdf, last time visited on 04/04/2018.
[12]Pension Watch, http://www.pension-watch.net/social-pensions-database/social-pensions-around-the-world/?keywords=universal+minimum+pension, last time visited on 04/03/2018.

[13]ibid.
[14]ibid.

Pensionet sociale të testuara janë ato ku kualifikimi bazohet në një test të të ardhurave dhe / ose pasurive të një individi. Qasjet e synuara ndryshojnë shumë. Shumë prej tyre gjithashtu përfshijnë një test të pensioneve brenda kritereve më të gjera. Të paktën 45 shtete kanë pension social të kontrolluar nga **means-tested**[15]. Është sfidë për Kosovën që të vendosë se si të vazhdojë lidhur me pensionin bazë. Duhen analizuar shembujt me format e pensioneve universale që zbatohen dhe për të parë se çfarë i përshtatet më së miri kushteve të Kosovës në përgjithësi.

Pensioni "means-tested" (i testuar)				
Argentina	Australia	Austria	Bangladesh	Belgium
Belize	Brazil (urban)	Cape Verde	Colombia	Ukraine
Costa Rica	Denmark	Dom Repub.	France	Uzbekestan
Georgia	Greece	Hong Kong	Ecuador	India
Indonesia	Ireland	Israel	Italy	Jamaica
Kenya	So Korea	Mongolia	Norway	Paraguay
Peru	Portugal	Philippines	Slovenia	South Africa
Spain	Trinidad&Tob	Turkey	Hungary	United Kingdom
USA	Chile	Uruguay	Venezuela	Vietnam

Figura 14. Shtetet që implementojnë pensionin "Means-tested" (i testuar)

b) Pensioni kontribuues

Pensioni kontribuues mbulon të gjithë individët të cilët "*kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65);*
1.2. duhet të kenë ***eksperiencën e punës së paguesit*** *të kontributit pensional, sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, Nr. 011-24 / 83 (Gazeta Zyrtare e SAPK Nr.26 / 83) para datës 1.01.1999 ".*[16]

	Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti Ligji Nr. 04/L-131			
Kriteri kryesor për përfituesin	1) Mosha 65+ 2) 15 vite të kontributit të paguar të punës para 1999 a) Kategorizimi në vitin 2016: 1) Shkolla fillore; 2) Shkolla e mesme: 3) Shkolla e lartë dhe 4) Fakulteti			
Shuma	€ 140.00	€ 140.00	€ 158	€ 158
			€ 172	€ 172
			€ 186	€ 186
			€ 230	€ 230
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfituesit	38,651	40,365	41,315	43,300
Shuma	€ 61,865,918.00	€ 68,237,577.00	€ 86,690,367.00	€ 90,672,452.00

Figura 15. Pensioni kontributiv, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

Megjithëse skema quhet kontribuuese, shuma e pensionit dhe kategorizimi nuk ka të bëjë me shumën e kontributit të paguar para vitit 1999 dhe është plotësisht e mbuluar nga buxheti i shtetit. Zbatimi i kësaj skeme ka filluar në vitin 2008, ndërsa në 2015 është bërë kategorizimi brenda kësaj skeme dhe ka filluar të zbatohet në 2016. Për shkak të të dhënave të pamjaftueshme në lidhje me kontributin e paguar para vitit 1999, kategorizimi është bërë sipas arsimit. Sipas këtyre kritereve ekzistojnë katër kategori: a) Arsimi fillor; b) Arsimin e mesëm; 3) Arsimi i Lartë dhe 4) Arsimi Superior. Shuma e pensionit ndryshon varësisht kategorisë në të cilën bëjnë pjesë përfituesit.

[15]ibid
[16]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji Nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, Neni 8 Paragrafi 1, 6 maj Prishtinë.

Kjo skemë pensionale është e përkohshme, teknikisht individët e fundit që mund ta marrin këtë pension janë ata të lindur në vitin 1966, të cilët supozohet se kanë filluar të punojnë me 18 vjet që do të thotë më 1984. Këta individë janë të fundit që teknikisht mund të marrin pension kontribuues dhe këta persona do të dalin në pension në vitin 2031. Teknikisht numri i individëve që marrin pension kontribuues mund të vazhdojë të rritet deri në vitin 2031. Pas vitit 2031 nuk do të ketë më shumë individë të rinj të cilët do të hyjnë në këtë skemë pensionale dhe kjo do të çojë në uljen e përfituesve dhe pas disa vitesh kjo skemë do të mbyllet. Lidhur me këtë skemë ekzistojnë disa çështje të hapura që ende kanë nevojë për përgjigje. Sipas Ligjit Nr. 04 / L-131, Neni 8, Paragrafi 6 thotë që "Me këtë ligj do të njihet përvoja e punës për pensionin kontribuues për vitet 1989-1999 të punonjësve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës". Ndërsa kontributi i punonjësve në sektorin e arsimit është njohur që nga viti 2016, sektori i shëndetësisë duhet të njihet, por mbetet e paqartë se cilët janë "të tjerët". Kjo duhet të specifikohet në ligj, përndryshe presioni ndaj Ministrisë do të vazhdojë nga grupe të ndryshme që pretendojnë se janë "të tjerët".

Pension Kontribues	
DoB	1966
Fillon punën	1984
15 vjet përvojë të punës	1999
Pensionimi	2031

Figura 16. Hyrja në skemë e përfituesve të fundit të pensionit kontributiv

Viti	2017
65+, estimation	144,718
Përfitues të Pensionit Bazë	122,716
Përfitues të Pensionit Kontribues	43,300
	- 21,298

Figura 17. Krahasimi i të dhënave nga ASK me të dhënat nga MPMS

Të dy skemat e pensioneve, ai bazë dhe kontribuues kanë të njëjtin kusht moshe 65+ dhe të qenit banorë të përhershëm në Kosovë. Numri i përfituesve të pensionit bazë dhe kontribuues nuk pasqyron numrin e personave mbi 65 vjeç që jetojnë në Kosovë. Sipas të dhënave dhe vlerësimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës numri i personave mbi 65 vjeç që jeton në Kosovë është shumë më i ulët se numri i përfituesve të pensionit bazë dhe kontribuues. Megjithëse në vitin 2016 numri i këtyre pensioneve bazë është zvogëluar për shkak të udhëzimit të ri administrativ të MPMS dhe menaxhimit më të mirë tëMinistrisë dhe Departamentit të Pensioneve; ka ende mijëra përfitues të pensionit bazë dhe kontribuues edhe pse nuk janë banorë të përhershëm të Kosovës.

C) Pensioni e aftësisë së kufizuar të përhershme

	Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti Ligji Nr. 04/L-131			
Kriteri kryesor për përfitues	1) Mosha 65+ 2) Banor i përhershëm i Kosovës 3)100% Paaftësi të përhershme			
Shuma	€			75.00
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfitues	18,318	19,056	19,833	19,481
Shuma	€ 16.821.950	€ 18,220,360.00	18,697,755.00	18,878,980.00

Figura 18. Pensionimi i aftësisë së kufizuar, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

Skema e pensioneve të aftësisë së kufizuar të përhershme zbatohet që nga viti 2002. Në fillim kjo skemë ka mbuluar të gjithë individët që kishin paaftësi të

përhershme. Kriteret kryesore[17] të përfituesve për këtë skemë janë: mosha 18-65 vjeç, duke qenë banor i përhershëm i Kosovës dhe 100% e paaftësisë së përhershme.
Ndërkohë janë miratuar dy ligje; ligj për personat me shikim të dëmtuar (të verberit) dhe ligji për personat tetraplegjikë dhe paraplegjikë. Përfituesit e këtyre dy skemave pensionale kanë kaluar nga skema e aftësisë së kufizuar të përhershme në skemën e tyre përkatëse. Pagesa për skemën e aftësisë së kufizuar është 75 euro, ndërsa pagesa për dy skema të tjera të veçanta është shumë më e lartë me pagesën e paraparë për medikamente dhe pagesa shumë e rëndësishme për ndihmësit personalë.
Nëse vazhdon trendi i njëjtë në të ardhmen, atëherë numri i individëve që marrin pension të aftësisë së kufizuar të përhershme do të ulet, ndërsa numri i ligjeve të veçanta do të rritet për grupe të ndryshme brenda këtyre skemave pensionale; Sindromi Down, Autizmi, etj. Sfida në këtë skemë pensionesh është, midis tjerash, nëse duhet të ketë ligje për çdo grup të paaftësisë apo të ketë një ligj për të gjitha grupet me aftësi të kufizuara. Tani për tani i kemi të dyjat, me anë të të cilave diskriminohen disa grupe me aftësi të kufizuara specifike; ata paguhen shumë më pak, edhe pse kanë pothuajse të njëjtat nevoja si grupet e mbuluara me ligje të veçanta

D) Skema pensionale e Trepçës

Pensioni i parakohshëm për minatorët e Trepçës është 105 euro. Kjo skemë kishte për qëllim të mbulonte të gjithë "... *minatorët e kompleksit" Trepça", dhe minatorët e tjerë të punësuar në miniera të tjera të Kosovës, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj*".[18] Ky nen është në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1, i cili thotë se "*Të drejten për pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë punonjësit e kompleksit" Trepça" dhe në minierat e tjera të Kosovës, të cilët kanë humbur vendin e tyre të punës deri në fund të viti 2004*[19]". Në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 1.7 thotë *"... minatorët e kompleksit"Trepça*"..." Neni 10 Paragrafi 1 thotë: "... *të gjithë punonjësit e kompleksit "Trepça"*," *minatorët*"dhe "*të gjithë punonjësit "e kompleksit të Trepçës*" bëjnë një ndryshim të madh. Përsëri, neni 10, paragrafi 2 është në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1, ndërsa është në të njëjtën linjë me nenin 3, paragrafi 1.7, ky nen thotë "Minatorë". Kriteret për pensionin e parakohshëm të Trepçës janë përcaktuar në nenin 10, paragrafi 2 dhe janë si më poshtë;

2. Pensionet e parakohshme do t'iu paguhen të gjithë minatorëve të kompleksit "Trepça" dhe minatorëve të tjerë të punësuar në minierat e Kosovës, dhe të punësuarve tjerë në miniera nëse:
2.1. janë shtetas të Republikës së Kosovës;
2.2. posedojnë dokumentet e identifikimit nga organi përkatës i Republikës së Kosovës;
2.3. nëse kanë moshën prej pesëdhjetë (50) – gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç;
2.4. kanë së paku dhjetë (10) vite stazh pune në miniera;

[17]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 9 paragrafi 2.6 Maj. Prishtinë.

[18]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 3 paragrafi 1.7.6. Maj. Prishtinë.

[19]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 10 paragrafi 1,6. Maj. Prishtinë.

2.5. nuk janë në marrëdhënie pune apo të vetëpunësuar;
2.6. nëse dëshmojnë se iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, pa fajin e tyre;
2.7. janë të paaftë për punë, për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tyre shëndetësore, me kusht që shkalla e invaliditetit të jetë mbi pesëdhjetë për qind (50%).[20]

Sfida për këtë skemë pensionesh është të sqarojë se kush do të përfitojë, minatorët ose të gjithë punonjësit e kompleksit të Trepçës. Përfituesit e kësaj skeme pensionale do të marrin këtë pension deri në moshën 65 vjeç, pas asaj moshe ata do të hyjnë në një ndërë skemat pensionale, varësisht për cilën i përmbushin kriteret. Në pak vite kjo skemë pensionale do të mbyllet, nuk do të ketë më aplikantë të rinj.

	Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti Ligji Nr. 04/L-131			
Kriteri kryesor për përfitues	1)Mosha 50-65 2)Banor i përhershëm i Kosovës 3) së paku 10 vite kontribut të paguar në sektorin minerar; 4) Paaftësi prej më shumë se 50% të shkaktuar nga puna;			
Shuma	€			105.00
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfitues	3,580	3,217	3,412	3,232
Shuma	€ 3,959,125.00	€ 4,424,825.00	4,386,425.00	4,199,430.00

Figura 19. Pensioni i Trepçës, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

E) Pensionet familjare

Pensionet familjare filluan të zbatoheshin në vitin 2018. Kriteret kryesore për të marrë pension familjar janë: a) "*...e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare*[21]*"; b) "anëtarët e ngushtë të familjes, të ish të siguruarit që ka vdekur pas datës 01.01.1999, të cilët dëshmojnë se i siguruari ka paguar për pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional"*[22]*; c) anëtarët e familjes të të punësuarit/ës, që kanë vdekur pas vitit 01.01.1999, si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e stazhit të punës*[23]*.*". Shuma për këtë pension është e njëjtë me pensionin bazë, 75 euro. Është e

	Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti Ligji Nr. 04/L-131
Kriteri kryesor për përfitues	1)Individët që kanë marrë pension familjar para vitit 1999 2)Banor i përhershëm i Kosovës 3) Familjet e individit që vdes dhe i cili ka qenë i siguruar dhe ka kontribuuar në sistemin pensional për së paku 15 vite para 1999 4) anëtarët e familjes të të punësuarit/ës, që kanë vdekur si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale
Shuma	75Euro plus 20% për secilin fëmijë nën 18 ose 26 nëse është në studime

Figura 20. Pensioni familjar, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

[20]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 10 paragrafi 2,6. Maj. Prishtinë.

[21]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 12 paragrafi 1,6. Maj. Prishtinë.
[22]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 12 paragrafi 2,6. Maj. Prishtinë.

[23]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 12 paragrafi 3,6. Maj. Prishtinë.

rëndësishme të theksohet se shuma e kësaj pensioni nuk merr parasysh pagën apo kontributin e paguar gjatë kohës së punës, çka nuk është rasti në pothuajse të gjitha sistemet e tjera të pensioneve të përdorura nga vende të ndryshme.

F) Pensioni invalidor i punës

Pensioni invalidor filloi të zbatohej në vitin 2018. Kriteret kryesore që duhet përmbushur janë të ketë 100% paaftësi si rezultat i aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Individët që kanë marrë këtë pension para vitit 1999 automatikisht do të vazhdojnë ta marrin nga 2018.[24]

	Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti Ligji Nr. 04/L-131			
Kriteri kryesor për përfitues	1) Individët nën 65 vjeç që e kanë marrë këtë pension para vitit 1999 2)banor i përhershëm i Kosovës; 3) Individët të cilët kanë 100% paaftësi për shkak të aksidentit në punë			
Shuma	€ 75.00			
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfituesit				
Shuma				

Figura 21. Pensioni invalidor i punës, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

Shuma e pensionit invalidor të punës dhe pensionit të paaftësisë së përhershme është 75 euro, që do të thotë se personat të cilët i plotësojnë kriteret për pension invalidor të punës praktikisht ata tashmë marrin pension të paaftësisë së përhershme, ndërsa kriteret kryesore janë të kenë 100% paaftësi të përhershme. Sfida kryesore këtu mbetet shuma e pensionit invalidor të punës dhe përqindja e paaftësisë. Çfarë ndodh me punëtorët që nuk kanë invaliditet të plotë për punë, por kanë 60% ose 70% të tij? Sipas legjislacionit aktual në Kosovë këta individë nuk do të marrin asnjë lloj mbështetjeje nga shteti pavarësisht nëse kanë punuar apo jo. Sfida e dytë është shuma e paguar, e cila është e njëjtë me pensionin e paaftësisë dhe pensionin bazë, aktualisht 75 euro. Nëse një person pëson një aksident në punë, edhe nëse paga e tij gjatë asaj kohe ishte më shumë se 1000 euro, ai do të marrë 75 euro. Vetëm nëse ai është "me fat" të ketë 100% paaftësi dhe t'i plotësojë kriteret për pension paraplegjik dhe tetraplegjik, atëherë do të marrë më shumë. Kjo skemë pensionesh duhet të diskutohet dhe të analizohet në mënyrë që të kemi trajtimin e duhur për këtë grup, invaliditeti për punë trajtohet ndryshe në shumicën e sistemeve pensionale, por në asnjërin prej tyre nuk trajtohet si në Kosovë.

Ligjet e veçanta

Përveç ligjit për pensionet e financuara nga shteti, ka ligje që mbulojnë pensionet për kategori të veçanta. Ligjet e tilla janë Ligji i Veteranëve të Luftës Nr. 04 / L-261, Ligji për Personat e Verbër në të Nr.04 / L-092, Ligji për Pensionet e TMK-së Nr. 08 / L-100, Ligji për FSK-në Nr. 04 / L-084, Ligji për vlerat e luftës, dhe Ligji për të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Më

[24]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2014), Ligji nr. 04 / L-131 për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 11 paragrafi 1,6. Maj. Prishtinë.

poshtë janë paraqitur tabelat individuale me një skemë të detajuar për secilin ligj që garanton pensione për kategori të veçanta në Kosovë.

1) Skema pensionale për persona të verbër Nr. 04/L-092

Kjo skemë pensionesh mbulon të gjithë personat e verbër pavarësisht moshës së tyre. Pensioni mujor i kësaj skeme është i lidhur me pagën minimale në Kosovë, sot nuk është më pak se 125 plus shuma e njëjtë do të paguhet për ndihmësin personal nëse ka vendim pozitiv të komisionit mjekësor për këtë. Përfituesit nga kjo skemë do të vazhdojnë ta marrin këtë pension edhe pasi të pensionohen në moshën 65 vjeç, nuk janë të detyruar të lëvizin në pensionin bazë ose në një skemë tjetër pensionale. Ndërsa numrat në tabelën e mësipërme në 2014, 2015 dhe 2016 tregojnë marrësit dhe ndihmësit personalë, numrat në vitin 2017 tregojnë vetëm përfituesit me dëmtime pamore dhe jo edhe ndihmësit e tyre personalë që gjithashtu paguhen.

	Skema Pensionale për Personat e Verbër Ligji Nr. 04/L-092			
Kriteri kryesor për përfitues	Personat e verbër, pavarësisht moshës			
Shuma	Jo më pak se 125 Euro, plus 125 euro për ndihmësit personalë. Shuma ndërlidhet me pagën minimale.			
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfituesit	3,144	3,387	3,627	2,001
Shuma	€ 5,440,580.00	€ 5,724,945.00	€ 5,410,507.00	€ 5,511,886.00

Figura 22. Skema pensionale për personat e verbër, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

2) Skema pensionale për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-100

Individët që përfitojnë nga kjo skemë pensionale, ndër të tjera duhet të jenë të paktën 45 vjeç dhe të kenë bërë shërbim minimal 5 vjeçar në TMK.[25] Anëtarët e familjes në kushte të caktuara janë gjithashtu përfitues të pensionit të TMK-së. Neni 11 për përfituesin direkt dhe neni 21 për përfituesin familjar të këtij ligji lejon që individët të vazhdojnë të marrin pension të TMK-së edhe kur ata janë në marrëdhënie pune, "Përfituesi do të ketë të drejtë të marrë pensionin pavarësisht ndonjë punësimi tjetër publik ose privat". Shuma e pensionit është e rregulluar me këtë ligj, Nenin 10, dhe përbëhet nga përqindja; 70% të pensionit të TMK-së dhe 50% për një

	Skema pensionale për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-100			
Kriteri kryesor për përfitues	Minimum 45 vjeç dhe shërbim minimal 5 vjeçar në TMK.			
Shuma	Mosha 45- 50% e pagës mesatare të 3 viteve të fundit në TMK Mosha 50- 70% e pagës mesatare të 3 viteve të fundit në TMK			
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfituesit	844	882	932	1,001
Shuma	€ 2,212,995.00	€ 2,451,475.00	€ 2,518,832.00	€ 2,685,482.00

Figura 23. Skema pensionale për trupat mbrojtëse të Kosovës, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

[25]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/ L-100 për pensionin për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Neni 7, Paragrafi 1.1, 10. Tetor. Prishtina.

pension të parakohshëm të TMK-së[26] dhe me pagën mesatare të tre viteve të fundit të paguara anëtarit përkatës të TMK-së. Përfituesit e pensionit të TMK-së sipas këtij ligji nuk kanë kufizime për të marrë pensione të tjera edhe pse ky lloj kufizimi është në pothuajse të gjitha ligjet e tjera. Për shembull, sipas ligjit për skemën e pensioneve të financuar nga shteti, neni 16, përfituesi i pensionit të TMK-së nuk mund të marrë pension kontribues, edhe nëse ai ose ajo i plotëson kriteret për atë pension, sipas këtij ligji ai duhet të vendosë se cilin pension dëshiron ta marrë. Sipas ligjit për pensionin e TMK-së nuk ka kufizime të këtij lloji.

3) Skema pensionale për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 04/L-261

Ligji për veteranët e luftës është ndryshuar në dhjetor 2016 me Ligjin Nr. 05 / L-141, por ende zbatohet ligji bazë derisa të finalizohet kategorizimi i veteranëve.[27]
Sipas Ligjit Nr. 04 / L-261, veteranët e luftës që përfitojnë nga kjo skemë sipas Nenit 3, Paragrafi 1.3.2 janë: "*qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK- së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës*". Sipas ligjit për veteranët e luftës, Neni 16, paragrafi 2 dhe 3, veterani i luftës "nuk mund të përfitojë ndonjë pension nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti" dhe po ashtu, veteranët e luftës "*që janë të punësuar në sektorin publik ose privat nuk kanë të drejtë ta marrin këtë pension*". Neni 17 i këtij ligji parasheh që veteranët e luftës të cilët janë "*të punësuar në sektorin publik dhe privat pas arritjes së moshës ligjore të pensionimit ka të drejtë në shtesë të pensionit për barazim me pensionin e veteranit luftëtar.*". Pensioni i veteranit luftëtar mund të trashëgohet pas vdekjes së veteranit nga bashkëshorti/bashkëshortja i papunë, fëmijët e mitur dhe prindërit e veteranit, nëse nuk janë përfitues të pensioneve të sigurimeve shoqërore. Niveli i pensionit për trashëgimtarët duhet të jetë 70% e pensionit të dhënë veteranit që ka vdekur.

	Skema pensionale për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 04/L-261			
Kriteri kryesor për përfitues	qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK- së dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës			
Shuma	170 euro			
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfituesit			28,207	36,032
Shuma			€ 47,864,133.49	€ 65,854,653.50

Figura 24. Skema pensionale për veteranët, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

Ndryshimet më të rëndësishme të bëra me Ligjin e ri për veteranët e luftës përfshijnë, kategorizimin e veteranëve të luftës në tri kategori bazuar në peridhën kur u bashkuan me UÇK-në, me pagesa të ndryshme për secilën kategori; buxheti i përgjithshëm për realizimin e pagesës së pensionit për

[26]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/ L-100 për pensionin për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Neni 10, Paragrafi 2.10. Tetor. Prishtinë.
[27]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2016), Ligji nr. 05 / L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Neni 16A, Paragrafi 3.1, 30 dhjetor. Prishtinë.

Luftëtarët Veteranë të UÇK-së nuk mund të kalojë 0.7% të Bruto Produktit Vjetor dhe veteranët e luftës që punojnë në ndërmarrjet private kanë të drejtë deri në 50% të pensionit veteran.

Shuma për secilën kategori është e përcaktuar në ligj. Neni 16A[28]:

a) Kategoria e Parë, dyqind e pesëdhjetë (250) Euro;

b) Kategoria e Dytë, njëqind e shtatëdhjetë (170) Euro;

C) Kategoria e Tretë, njëqind e njëzet (120) Euro..

Neni 16A, paragrafi 6 parasheh që "*në rastin e tejkalimit të 0,7% të Bruto Produktit Vjetor, atëherë ulja e pensionit ndodh proporcionalisht për të gjithë përfituesit e këtijligji*".

Sfidat për këtë skemë pensionesh janë të shumta duke përfshirë kategorizimin. Më e rëndësishmja mbetet numri i veteranëve të luftës që përfitojnë nga kjo skemë, ekziston një argument i përgjithshëm i të të gjitha grupeve të përfshira në këtë skemë pensionale që numri aktual është i lartë dhe nuk pasqyron numrin real të veteranëve të luftës.

4) Skema pensionale për Forcat e Sigurisë të Kosovës Nr.04/L-084

Ligji për pensionin për FSK parashikon pension për anëtarët aktivë të FSK-së, pensionin invalidor të anëtarit të FSK-së, pjesëtarët rezervë të FSK-së dhe për familjet e tyre në rast vdekje të pjesëtarit të FSK-së. Shuma e pensionit për pjesëtarët aktivë të FSK-së është e shkruar në ligj, Nenin 7 Paragrafi 2 i cili thotë "*Baza e pensionit të rregullt të pjesëtarit aktiv të FSK-së është dyzet përqind (40%) e pagës bruto së pjesëtarit të FSK-së në momentin e pensionimit. Për çdo vit shërbimi si pjesëtar aktiv i FSK, koeficienti i përqindjes rritet për dy përqind (2%), por nuk mund të kaloj gjashtëdhjetë përqind (60%) e pagës bruto.*". Shuma e pensionit invalidor të pjesëtarit të FSK-së sipas Nenit 7, paragrafit 3 është "*Lartësia e pensionit invalidor të pjesëtarit të FSK-së llogaritet varësisht nga shkalla e paaftësisë së përhershme për punë të fituar në shërbim. Pjesëtari aktiv realizon pensionin invalidor nga njëzet deri njëqind përqind (20-100%) të pagës bruto, në momentin e invaliditetit. Për çdo vit të shërbimit, si pjesëtar aktiv i FSK-së, pagesa financiare rritet për dy përqind (2%) në koeficientin e përqindjes, por nuk mund ta kaloj njëqind përqind (100%) të pagës bruto.*"

	Skema pensionale për Forcat e Sigurisë të Kosovës Nr.04/L-084			
Kriteri kryesor për përfitues	Mosha minimale 50 për NCO, dhe 55 për oficerë; Minimum 20 vite shërbimi; Ish anëtar i TMK-së që shërben së paku 3 vjet në FSK			
Shuma	40% e pagës së fundit bruto plus 2% për secilin vit shërbimi, por nuk mund ta kaloj 60% të pagës bruto			
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfituesit	134	171	218	288
Shuma	€ 424,189.00	€ 591,961.00	€ 766,051.00	€ 1,201,248.00

Figura 25. Skema pensionale e FSK-së, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

Pjesëtarët rezervë të FSK-së janë të kualifikuar për pension tërregullt të FSK-së kur të kenë së paku 20 vjet shërbimi në FSK dhe ta kenë arritur moshën 65. Sipas Nenit 10, paragrafit 1 "*Lartësia e pensionit të rregullt të pjesëtarit rezervë të FSK-së, llogaritet në*

[28]Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2016), Ligji nr. 05 / L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Neni 16A, Paragrafi 4. 30 dhjetor. Prishtinë.

bazë të përqindjes së pagës bruto të pjesëtarit dhe kohës së shërbimit" dhe paragrafit 2 "*Përqindja e pensionit llogaritet nga zero pikë pesë përqind (0.5%) për çdo vit të shërbimit në FSK, bazuar në gradën që bart pjesëtari në momentin e pensionimit.".*

E drejta për pension familjar në rastin e vdekjes së anëtarit të FSK-së e u takon bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve. Pensioni i bashkëshortit është 60% e pensionit të anëtarit të FSK-së që vdes, pensioni i fëmijëve është 10% për secilin fëmijë, por nuk duhet të kalojë 40% të pensionit të anëtarit të ndjerë të FSK-së. Njërit nga prindërit i takon në 60% e pensionit të anëtarit të vdekur të FSK-së.

5) Ligji për vlerat e luftës Nr.04/L-054

Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre zbatohet që nga viti 2012. Ky

	Ligji për pensionin për vlerat e luftës, Ligji Nr. 04/l-054									
Kategoritë e përfituesve	Familjet e dëshmorëve	Invalid i Luftës së UÇK-së	Invalid civil i luftës	Viktimë Civile e Luftës	Kujdestar për invalidë të luftës	Kujdestar për familjet e invalidëve të luftës pas vdekjes së tyre	Kujdestar për familjet e të pagjeturve në luftë	Kujdestar për invalidë civilë të luftës	Familjet e personave civilë të pagjetur	Familjet e invalidëve civilë pas vdekjes së tyre
Kriteri kryesor për përfitues	Anëtarë të familjes së ngushtë	Invalid i Luftës së UÇK-së me invaliditet prej 20%-100%	Invalid civil i luftës me invaliditet prej 40%-100%	Anëtarë të familjes së ngushtë	Kujdestar për invalidë të luftës me invaliditet prej 81% - 100 %	Anëtarë të familjes së ngushtë	Anëtarë të familjes së ngushtë	Kujdestar për invalidë civilë të luftës me invaliditet prej 81% - 100 %	Anëtarë të familjes së ngushtë	Anëtarë të familjes së ngushtë
Shuma	një dëshmor: 448.13 € dy dëshmorë: € 537.76 tre dëshmorë: 582.57 € katër dëshmorë: 627.39 € më shumë se katër dëshmorë: € 672.19	Dëmtim trupor mbi 80%: 448.13eur 71-80%: 412.5 € 61-70%: 393.75 € 51-60%: 375 € 41-50% : € 356.25 31-40%: 318.75 € 21-30%: 225 € +	Dëmtim trupor mbi 80%: 152.5 € 61-80%: 136.25 € 40-60%: 120 € + kujdestar për invalid me dëmtim trupor mbi 80%: 50.13 €	Një viktimë: 168.75 € dy viktima: 202.50 € tri viktima: 219.38 € katër viktima: € 236.25 katër e më shumë viktima : € 253.13	kujdestar për invalid me dëmtim trupor mbi 81%: 225 Euro	80%: 385.50 € 71-80%: 330 € 61-70%: 315 € 51-60%: 300 € 41-50%: 285 € 31-40%: 255 € 21-30%: 180 €		Kujdestar për invalid civil me dëmtim trupor mbi 80%: 50.13€	një të pagjetur: 168.75 € dy të pagjetur: 202.50 € tre të pagjetur: 219.38 € katër të pagjetur: € 236.25 katër e më shumë të pagjetur: € 253.13	Dëmtim trupor mbi 80%: 123.25 € 61-80%: 110.25 € 40-60%: 97.25 €

Figura 26. Skema pensionale për vlerat e luftës, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

ligj mbulon pothuajse të gjitha kategoritë e ndryshme që si rezultat i luftës kanë nevojë për mbështetje nga Shteti. Siç tregohet në tabelën e mësipërme, në kuadër të këtij ligji ekzistojnë 10 skema të ndryshme të pensioneve duke përfshirë kujdestarët për disa kategori. Në përgjithësi numri i përfituesve është zvogëluar dhe pritet të vazhdojë të zvogëlohet në të ardhmen. Tabela më poshtë tregon numrin e përfituesve në katër vitet e fundit dhe shumën totale të paguar për këtë kategori.

	Ligji për pensionin për vlerat e luftës, Ligji Nr. 04/l-054			
Viti	2014	2015	2016	2017
Përfituesit	13,097	12,951	12,680	12,472
Shuma	€ 35,988,761.00	€ 37,694,371.00	€ 37,292,179.82	€ 36,693,456.76

Figura 27. Skema pensionale për vlerat e luftës, përfituesit dhe shuma në euro përgjatë viteve

6) Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetrapelgjikë. Ligji Nr.05/L-067

Kjo skemë pensionale ka filluar të zbatohet në vitin 2018. Deri tani individët që përmbushin kriteret për këtë skemë duhet të kenë marrë pension të paaftësisë së përhershme.

	Law on the status and rights of paraplegic and tetraplegic persons Law No. 05/L-067
Kriteri kryesor për përfitues	Individët paraplegjikë and tetraplegjikë
Shuma	170 euro plus 170 euro për kujdestar personal plus 50% të kompensimit shtesë në varësi të gjendjes së paaftësisë

Figura 28. Skema pensionale për paraplegjik dhe tetralegjik, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro

Normalisht tani në fillim të implementimit të kësaj skeme sa më shumë persona do të hyjnë nën këtë skemë aq do të përjashtohen nga skema e paaftësisë së përhershme.

7) Ansambli Shota

	Skema pensionale për ansamblin Shota Ligji Nr. 04/L-164
Kriteri kryesor për	Mail members age 50 Female members age 45
Shuma	E pa definuar

Figura 29. Skema pensionale për Ansamblin Shota, kriteret, përfituesit dhe shuma në euro

Nuk ka marrës të këtij pensioni deri me tani.

Shqyrtim i skemave pensionale të financuara nga buxheti i shtetit

Skemat pensionale nga shtylla e parë së bashku me skemat e pensioneve të rregulluara me ligj të veçantë financohen nga buxheti i shtetit. Në afat të gjatë kjo paraqet sfidë e madhe për buxhetin e Kosovës duke ditur se në vitin 2017 shuma e përgjithshme e këtyre skemave pensionale ishte rreth 338 milionë euro nga një buxhet i përgjithshëm i Kosovës prej 1.8 miliardë euro për vitin 2017. Edhe më e rëndësishme është se edhe pse shuma totale aq e lartë, në përgjithësi pensionet janë shumë të ulëta. Tendenca është që skema të reja pensionale me siguri do të futen në implementim dhe shpenzimet totale do të jenë më të larta, por pensionet do të mbeten të ulëta.

Një çështje tjetër që duhet të adresohet është se edhe pse në Kosovë sipas vlerësimit të ASK-së në vitin 2017 ka pasur rreth 144, 718 persona mbi moshën 65 vjeçare dhe banorë të përhershëm të Kosovës, janë ende 166.016 persona që marrin pension bazë dhe kontribues. Nëse të dhënat e ASK-së duhet të besohen, atëherë janë mbi 21,000 mijë individë të cilët marrin një nga këto dy pensione pa përmbushur kriteret për rezident të përhershëm. Një arsye për të besuar se këto të dhëna janë të besueshme është ulja e përfituesve të Pensionit Bazë nga viti 2015 në 2016 për më shumë se 15,000 mijë. Sipas të dhënave të MPMS-së nga viti 2017 ekzistojnë rreth 64,222 persona më të rinj se 65 vjeç dhe marrin të paktën një lloj të pensionit.

Edhe pse ka shumë nene në ligje të ndryshme (jo në të gjitha) që ndalojnë mundësinë e marrjes së dy ose më shumë pensioneve të financuara nga buxheti i shtetit, kjo ka ndodhur në të kaluarën. Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, Neni 16, është shumë i qartë dhe thotë se "Personat që përfitojnë ndonjë pension të skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, në asnjë rrethanë, nuk mund të përfitojnë ndonjë pension nga skemat pensionale të veçanta që janë menaxhuar dhe administruar nga Ministria ".
Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, Neni 5, paragrafi 1.4 thotë që "përfituesit e pensioneve sipas paragrafit 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni tjetër nga skema të tjera pensionale të zbatueshme në Kosovë, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë ligj ".Ligji për pensionin e FSK-së, Neni 5, paragrafi 3 thotë se "Përfituesit që kanë të drejtën e pensionit të FSK-së të paraparë me këtë ligj duhet të zgjedhin njërin nga përfitimet e mëposhtme: pensionin që u takon me këtë ligji ose përfitime të tjera të parapara me ligje të tjera në fuqi".Edhe pse këto nene janë shumë të qarta, deri në vitin 2015 mijëra individë kanë marrë më shumë se një pension.

Në anën tjetër, neni 16 i ligjit për skemën pensionale të financuar nga shteti individëve që kanë ardhur të jetojnë në Kosvë, pas daljes në pension nga një vend tjetër,u jep të drejtë për Pension Bazë, edhe pse marrin pension nga një shtet tjetër që është kryesisht një pension shumë i lartë krahasuar me pensionet e Kosovës. Në anën tjetër e kanë ndaluar këtë për kosovarët që marrin 75 euro dhe plotësojnë kriteret për një pension tjetër prej disa qindra eurosh. Për shembull, një kosovar që ka punuar në Gjermani apo Zvicër, ka mbushur moshën 65 vjeç dhe ka dalë në pension, kthehet për të jetuar në Kosovë, atij i sigurohet e drejta të marrë pensionin bazë ose pensionin kontribues, edhe pse ai është duke marrë një pension prej më shumë se 1000 euro nga vendi ku ai ka punuar. Përkundrazi, një kosovar që jeton në Kosovë, i cili është 65 vjeç, është duke marrë pensionin bazë dhe i plotëson kriteret për një pension tjetër nga skemat e tjera të pensioneve, p.sh. pensionin e FSK-së, ai duhet të zgjedhë njërin pension që ai të mos i marrëtë dyjat.
Me Ligjin e Vlerave të Luftës, paaftësia paguhet nga 20% e lart. Sipas këtij ligji, paaftësia e 20% paguhet tre herë më shumë se 100% e paaftësisë me Ligjin për paaftësinë e përhershme. Pensioni i invaliditetit të punës paguhet vetëm kur paaftësia është 100% dhe shuma është e njëjtë me pensionin për paaftësi të përhershme, nuk e merr parasysh kontributin e paguar ose pagën para se të bëhet i paaftë.

Kjo na çon më tej në çështjen e radhës, çfarë ndodh me individët që kanë aksident në punë ose për shkak të sëmundjes profesionale kanë paaftësi prej 20%, 40%, 50% dhe më tej. Sipas ligjit aktual ata nuk marrin pothuajse asgjë në afat të gjatë; ata do ta humbasin punën dhe nuk do të kenë fare të ardhura.

Krahasimi për pagesat për paaftësi nga buxheti i Kosovës				
	Shtylla I		Skemat e veçanta pensionale	
Paaftësia	Pensioni për paaftësi të përhershme	Pensioni për paaftësi për punë	Invalid Civil i Luftës	Invalid i Luftës së UÇK-së
21%-30%				€ 225.0
31%-40%				€ 318.8
41%-50%			€ 120	€ 356.3
51%-60%				€ 375.0
61%-70%			€ 136	€ 393.8
71%-80%				€ 412.5
81%-100%			€ 152.00	€ 448.1
100%	€ 75.0	€ 75.0		

Figura 30. Krahasimi i pagesave për aftësi të kufizuar me pagesën dhe shkallën e invaliditetit

Këtu është e rëndësishme të diskutohet çështja e sigurimit nga aksidenti në punë. Kjo është një shtyllë që shumica e vendeve e kanë dhe në të ardhmen kjo mund të bëhet problematike për Kosovën në nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me vendet e tjera, veçanërisht me vendet ku diaspora kosovare është shumë e madhe, por më e rëndësishmja është çfarë ndodh me këta njerëz.

Në Shtyllën e Parë dhe në Ligjet e Veçanta për skemat e pensioneve mbetet një çështje shumë e rëndësishme, a mund të vazhdojë Kosova të paguajë të gjitha skemat e pensioneve pa marrë ndonjë kontribut, apo është Kosova e gatshme t'i paguajë të gjitha këto skema pensionale nga buxheti, ndërkohë që shumë nga marrësit e pensioneve janë duke e paguar kontributin e pensionit në një entitet tjetër. Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje do ta sqarojë rrugën që do të marrë reforma e pensioneve.

Shqyrtimi i Shtyllës së Dytë

Shtylla e dytë e skemës së pensioneve në Kosovë është e detyrueshme dhe bazohet në kontributin e paguar nga punonjësi dhe punëdhënësi. Pagesa e detyrueshme është 10% e pagës, secili 5%; por në baza vullnetare kjo mund të shkojë deri në maksimumin prej 15%.

Shtylla e dytë		
Viti	Të mbledhura	Të tërhequra
2012	€ 113,000,000.00	€ 8,700,000.00
2013	€ 119,200,000.00	€ 10,700,000.00
2014	€ 128,700,000.00	€ 14,300,000.00
2015	€ 137,500,000.00	€ 19,300,000.00
2016	€ 151,500,000.00	€ 19,200,000.00
2017	€ 159,800,000.00	€ 27,440,000.00

Figura 31. Shkalla e dytë, pagesat dhe tërheqjet gjatë viteve

Figura 31 tregon të dhënat nga shtylla e dytë në 6 vitet e fundit, shuma që mblidhet dhe shuma që paguhet. Në të ardhmen pritet që të dy shumat të rriten. Në vitin 2017, shtylla e dytë po menaxhonte më shumë se 1.6 miliardë euro. Nëse shohim prirjet në grumbullimin dhe tërheqjen nga shtylla e dytë, nëse parashikojmë plakjen e popullsisë së Kosovës, nëse parashohim përafërsisht rritjen ekonomike në Kosovë, atëherë mund të presim që shuma totale e menaxhuar nga shtylla e dytë vetëm të rritet.

Në të ardhmen e afërt do të ketë më shumë se 3 miliardë euro të menaxhuara nga Shtylla e Dytë, ndërsa shuma e mbledhur vjetore do të jetë e mjaftueshme për të paguar ata që do ta arrijnë moshën e pensionimit. Miliarda euro do të fillojnë të shpenzohen vetëm kur tërheqja të jetë më e lartë se mbledhja. Pensionet paguhen kur një person arrin moshën e pensionit prej 65 vjeç ose më herët për shkak të paaftësisë të përhershme. Pagesa bëhet në tri mënyra në varësi të shumës që ruhet. Nëse shuma e kursyer në moshën e pensionit është nën 3000 Euro, atëherë kjo shumë paguhet menjëherë me një ratë. Nëse shuma është më e madhe se 3000 euro, por më e vogël se 20000 euro, atëherë marrësit do të marrin 200 euro në muaj derisa sa të shpenzohen krejt paratë. Nëse shuma e parave të kursyera është më e madhe se 20000 euro, atëherë marrësit do të marrin 1% të shumës totale ne muaj derisa paratë të shpenzohen, brenda 100 muajve.Në çfarëdo rrethane, pensionimi nga shtylla e dytë nuk mund të zgjasë më shumë se 8 vjet dhe 4 muaj (100 muaj), pa marrë parasysh se sa të holla ruhen. Shembull në figurën 32 tregon se çdo person që kursen para në shtyllën e dytë, do t'i marrë të gjitha paratë e tij maksimalisht brenda 8 viteve dhe 4 muajsh, praktikisht deri në moshën 73 vjeç e 4 muaj ai do të marrë pensionin e tij të fundit nga shtylla e dytë. Pas kësaj moshe, pensionisti do të vazhdojë të marrë vetëm pension bazë nga buxheti i shtetit që aktualisht është 75 euro ose pension tjetër nëse ai/ajo plotëson kriteret e kërkuara. Këtu është e rëndësishme të shihet se çfarë do të thotë pensioni dhe nëse shtylla e dytë plotëson kriteret për t'u quajtur pension.

Shembull për pagesën e pensionit të Shtyllës së dytë										
	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	Total
Shuma totale e kursyer 50,000.00 Euro	Year 1	Year 2	Year 3	Year 4	Year 5	Year 6	Year 7	Year 8	4 Muaj	8 vjet e 4 muaj
Pagesa mujore 1%, 500 Euro	€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 2,000	€ 50,000

Figura 32. Sa zgjatë pagesa nga shtylla e dytë

Sipas fjalorit të Cambridge, pension do të thotë "një shumë parash që paguhet rregullisht nga qeveria ose një kompani private për një person që nuk punon më sepse janë shumë të moshuar ose janë sëmurë". Përkufizimi këtu nuk thotë se sa kohë do të paguhet pensioni, por thotë se kur fillon të paguhet dhe na lejon të kuptojmë se kjo do të zgjasë për sa kohë që jetojmë. Ligji për fondet e pensioneve të Kosovës në Kapitullin 1, Neni 1, ku janë përkufizimet, thuhet se pensionet janë "një pagesë e rregullt mujore e bërë për një Pjesëmarrës (ose Përfitues) **për jetë**, duke filluar nga Periudha e Pensionit, paaftësia ose vdekja e Pjesëmarrësit sipas këtij ligj"[29]. Shtylla e dytë e skemës pensionale në Kosovë përmbush kriteret kur është fjala për fillimin e pagesës së pensionit por nuk i plotëson kriteret e pagesës për jetë pas pensionimit. Në këtë rast edhe pse paguajmë detyrimisht nështyllën e dytë për sa kohë që punojmë,në fund ne nuk do të marrim pension nga kjo shtyllëpër sa kohë që jetojmë. Kjo është më shumë llogari kursimi, dhe ky është problem. A ka qeveria të drejtë t'i detyrojë qytetarët e saj që t'i kursejnë paratë e tyre në një fond të veçantë pa u dhënë atyre asnjë lloj garancie, as për pension, madje aspër paratë nëse humbasin. Nëse qeveria i detyron qytetarët e saj të paguajnë në një fond të posaçëm, atëherë ajo duhet të garantojë përse

[29]Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04 / L-131 për fondet pensionale të Kosovës, Kapitulli 1, Neni 1 Përkufizimi, 6 prill 2012, Prishtinë.

kursehenparatë dhe kjo pastaj i jeprol më të madh shtetit në shtyllën e dytë. Pagesa mujore e shtyllës së dytë nuk është një pension për sa kohë që nuk paguhet gjatë gjithë jetës pas pensionimit. Figura 33 tregon se edhe pas 15 vitesh të krijimit të kësaj shtylle, personat të cilët ndërkohë janë pensionuar mesatarisht marrin pension nga kjo shtyllë vetëm për disa muaj. Këto të dhëna tregojnë

Pagesat në shtyllen e dytë gjatë viteve										
Viti	Tërheqje në mil Euro	Total	65+	Shuma	65+ më pak se 3,000 euro	Shuma	65+ më shumë se 3,000 euro	Shuma	Mesatarisht	Muaj që do të paguhen
2012	€ 8,700,000.00	3,864	2,484	€ 6,453,000.00	1,790	€ 2,485,000.00	694	€ 3,968,000.00	5,717.58	29
2013	€ 10,700,000.00	3,567	2,676	€ 8,259,000.00	1,402	€ 1,572,000.00	1,274	€ 6,687,000.00	5,248.82	26
2014	€ 14,300,000.00	4,045	3,095	€ 11,342,000.00	1,556	€ 1,538,000.00	1,539	€ 9,804,000.00	6,370.37	32
2015	€ 19,300,000.00	4,438	3,468	€ 15,897,000.00	1,468	€ 1,510,000.00	2,000	€ 14,387,000.00	7,193.50	36
2016	€ 19,200,000.00	4,445	3,432	€ 15,176,000.00	1,641	€ 1,441,000.00	1,791	€ 13,735,000.00	7,668.90	38
2017	€ 27,440,000.00	5,175	4,036	€ 22,779,000.00	1,552	€ 1,641,000.00	2,484	€ 21,138,000.00	8,509.66	43
2018	€ 12,100,000.00	3,868	2,083	€ 10,467,000.00	1,030	€ 745,000.00	1,053	€ 9,722,000.00	9,232.67	46

Figura 33. Pagesat në shtyllën e dytë gjatë viteve

se kursimet e shtyllës së dytë shpenzohen në më pak, brenda apo vetëm më shumë se tri vjet, që do të thotë se individët që kanë kursyer në shtyllën e dytë do të mbeten pa këtë pension kur ta arrijnë moshën 69 vjeçare. Në vitin 2017 pensioni nga shtylla e dytë ka zgjatur mesatarisht vetëm 43 muaj.

Të dhënat nga Shtylla e Dytë nuk premtojnë shumë për të ardhmen. Pagesa mujore nuk është shumë e lartë, edhe pse gjatë 5 viteve pagesa mujore është rritur, por është aq e ulët sa që luan rol të vogël për pensionistët e ardhshëm të kësaj skeme. Edhe nëse kemi një çudi ekonomike në Kosovë dhe të fillojmë të paguajmë 100 euro në muaj nga ky vit (në atë rast paga mesatare në Kosovë do të jetë 1000 euro), në fund nëse punojmë 40 vjet do të kemi kursyer 48000 euro . Kjo do të thotë se në vitin 2058 ne do të marrim një pension prej 480 Euro për 8 vjet dhe 4 muaj, pothuajse deri në vitin 2066. Dy pyetje kërkojnë përgjigje në këtë mes: cila do të jetë vlera reale prej 480 Euro në vitet 2058-2066 dhe çfarë do të ndodhë pas arritjes së moshës 73 duke ditur se njerëzit jetojnë më gjatë çdo vit?

Kontributi mesatar në shtyllën e dytë				
Viti	Punëmarrësi Mujor	Punëdhënësi Mujor	Punëmarrësi Vjetor	Punëdhënësi Vjetor
2012	€ 38.56	€ 25.58	€ 462.72	€ 306.96
2013	€ 38.94	€ 29.80	€ 467.28	€ 357.60
2014	€ 41.29	€ 30.41	€ 495.48	€ 364.92
2015	€ 42.21	€ 31.48	€ 506.52	€ 377.76
2016	€ 44.42	€ 32.25	€ 533.04	€ 387.00

Figura 33. Pagesa mesatare mujore ndër vite

Pyetje të tjera që kanë nevojë për përgjigje janë të tilla si çka do të ndodhë nëse kemi kolaps ekonomik global sikurse kemi pasur në vitin 2008. Në atë vit shtyllës së dytë iu nevojitën 6 vjet për t'u rimëkëmbur nga humbjet për shkak të kolapsit ekonomik. Çfarë do të ndodhë nëse banka ku i kursej paratë e mia falimenton? Bankat në Kosovë nuk janë të siguruara 100%. Shembulli më i keq mund të jetë që ta marr pensionin tim të parë në maj 2018 dhe në qershor 2018 banka të falimentojë. Nuk do të marr më pension dhe paratë e mia, kursimet e mia nga 16 vjet (2002-2018) thjesht humbasin. Një gjë është e sigurt, nëse duam pension për tërë jetën pas moshës 65 vjeç dhe nëse

duam garanci për paratë që i kemi kursyer,atëherë shteti duhet të marrë më shumë përgjegjësi për shtyllën e dytë, çka saktësisht dhe si mbetet për t'u eksploruar dhe diskutuar.

Shembuj nga shtetet e tjera

Suedi

Misioni qendror i sistemit pensional të Suedisë është të sigurojë, për aq sa mundet, një standard të mjaftueshëm jetese për njerëzit në pleqëri nëpërmjet një përfitimi të paguar për një punonjës i cili tërhiqet nga puna e tij pas moshës së përcaktuar. Me një përjashtim për nëpunësit civilë, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të mbrojtjes dhe oficerët e policisë, të cilët mund të marrin pensionet e pleqërisë në kushte të favorshme, siç është e drejta për të dalë në pension më herët, pensionet që u paguhen punonjësve më herët se mosha e përcaktuar hyjnë në pagesat sociale që paguhen nga punëdhënësi dhe jo pensione.



Figura 35. Sistemi pensional në Suedi

Shtylla e parë e sistemit pensional të Suedisë është pensioni publik. Pensionet publike kryhen në bazë të tre sistemeve: pensioni i bazuar në të ardhura që arrin në 17.21% të të ardhurave të tatueshme; pensionet premium të cilat arrijnë në 2.5%; pensionet e garantuara për ata që kanë pak ose aspak të ardhura nga puna. Dy sistemet e para financohen bashkërisht nga punëdhënësi dhe punonjësi; i treti (pensionet e garantuara) financohet nga qeveria qendrore me një normë të reduktuar për një person me pension të ardhurash.

Arsyeja pse personi i cili ka një burim të ardhurash merr edhe një pension bazë të moshës me shumë më të ulët, është për shkak se ekziston pritja që pensionet mund të mbulohen edhe nga pensionet kontribuese. Përndryshe, pensioni financohet nga buxheti i qeverisë qendrore vetëm nëse personi nuk ka pasur një punë adekuate, prandaj nuk është në gjendje të marrë pension të përshtatshëm dhe si i tillë mund të marrë pensionin e garantuar. Për individët me përfitim të ulët të garantuar për shkak të vendbanimit të shkurtër në Suedi, p.sh. emigrantët që kanë mbërritur në mes të jetës, ka një pension minimal të të ardhurave. Pra, vetëm 1/3 e pensioneve publike, respektivisht pensionit të garantuar, ndonjëherë financohet drejtpërdrejt nga buxheti kombëtar/të ardhurat e përgjithshme, ndërsa 2/3 të tjera të pensioneve publike financohen nga të ardhurat dhe premiumet; në thelb shtylla e parë vetëfinancohet.

Shtylla e dytë e sistemit pensional të Suedisë janë skemat profesionale. Këto janë të përcaktuara nga marrëveshjet kolektive; specifikisht ekziston një plan i veçantëpër punonjësit white collars (punëtorë në zyra apo punëtorë profesional) të punësuar privatisht, një plan për punonjësit blue collars (punëtorë) të punësuar privatisht, një plan për nëpunësit civilë/punonjësit e qeverisë qendrore (përfitimidhe kontributi i kombinuar) dhe një plan për nëpunësit civilë/punonjësit komunalë (përfitimi dhe kontributi i kombinuar). Financimi pensional për dy llojet e para është një kontribut i përcaktuar prej 4.5% të pagës, dhe për dy të tretat është një plan i kombinuar i përfitimit



dhe kontributit, respektivisht një pay-as-you-go për komponentin e përfitimit dhe 2.3% dhe 4.5 % për komponentin e kontributit.

Shtylla e tretë e sistemit pensional të Suedisë është pensioni privat. Këto ofrohen si pension jetësor. Pensioni është i tatueshëm së bashku me të ardhurat. Zbritjet në taksa janë të zbatueshme, deri në limite.

Slovenia

Fondet e alokuara të pensioneve të Sllovenisë janë 4.4 miliardë euro, por vetëm 1.3 miliardë rrjedhin nga buxheti i shtetit. Kontributet pensionale dhe sigurimet e invaliditetit paguhen nga fondi i pensionit, i përbërë nga paratë e paguara nga punëdhënësit dhe punëtorët për një punonjës. Përfitime të tjera të tilla si për papunësi, përfitimet familjare, të tilla si ato të familjeve të veteranëve të luftës dhe skema të tjera të asistencës sociale paguhen përmes një fondi tjetër. Ato nuk përbëjnë pensione.

Shtylla e parë e sistemit të pensioneve sllovene është skema obligative e PAYG. Shkalla e kontributit arrin në 24.35% të pagës bruto, ku punonjësit paguajnë 15.5%, punëdhënësit kontribuojnë me 8.85%, dhe të vetëpunësuarit duhet ta mbulojnë shumën totale. Kjo shtyllë gjithashtu mbulon një **nivel zero**, të financuar nga shteti, me qëllim që t'i mbulojë ata që kanë mbetur të pambrojtur nga skema e përgjithshme e pensioneve. Shtylla e dytë është një skemë profesionale. Është e detyrueshme në shërbimin publik, në sektorin bankar dhe në profesione të rrezikshme; dhe vullnetare në sektorë të tjerë (nëse të paktën dy të tretat e të punësuarve pajtohen të bashkohen). Pothuajse 50% e të punësuarve janë të regjistruar në sistemin profesional vullnetar. Pavarësisht disa sfidave të parashikueshme, shtylla e dytë profesionale e Sllovenisë ka arritur mbulim të lartë dhe depërtimi i sigurimit jetësor është më i larti në rajon. Shtylla e tretë është një skemë private-vullnetare. Ai përfaqëson kursimet personale, duke iu nënshtruar lehtësimit të taksave.

Figura 36. Sistemi pensional në Slloveni

Krahasimet

Pensionet publike janë pensione të garantuar, por jo domosdoshmërisht pensioneve të financuara nga shteti[30]. Duke iu referuar shembullit të Suedisë, buxheti i saj kombëtar ndan një shumë të madhe të fondeve të saj në programet sociale, por jo në pensionet publike. Skema pensionale e Kosovës i asimilon të gjitha;

[30]Organisation for economic co-operation and development, (2011), "Estonia, review of the private pensions systems." [Online]. Available at: http://www.oecd.org/finance/private-pensions/49498084.pdf.

shtyllën e parë/pensionet publike në pensionet shtetërore (TRUSTI i cili financohet ndaras, është pjesë e shtyllës së dytë).

Viti	2014	2015	2016	2017
Të hyrat e përgjithshme	€ 1,345,000,000.00	€ 1,470,000,000.00	€ 1,634,000,000.00	€ 1,725,000,000.00
Të hyrat nga tatimi direkt	€ 188,000,000.00	€ 207,000,000.00	€ 222,000,000.00	€ 232,000,000.00
Shpenzimet e përgjithshme	€ 235,025,738.00	€ 263,612,431.00	€ 321,226,929.82	€ 338,776,663.26

Figura 37. Prirjet për shpenzim të buxhetit për pensione. Burimi: Gazeta e RKS

Në fakt, shtylla e parë e Kosovës është një nga të rrallat që financohet plotësisht nga buxheti i shtetit; 326,941,674 euro parashikoheshin të shpenzohen për financimin e skemave të shumta pensionale për vitin 2017 (pa llogaritur skemat sociale); që përbën pothuajse 20% të të ardhurave totale të vendit. Kjo është pjesë shumë e madhe e buxhetit të shpenzuar për pensionet, sidomos duke pasur parasysh se shumica e vendeve po ndjekin një politikë të privatizimit të sistemit të pensioneve. Për shembull, shpenzimet e buxhetit të Suedisë për pensione përbëjnë rreth 6.6% në të gjitha paratë e shpenzuara për kategoritë sociale.

Për më tepër, për buxhetin e Kosovës, shuma e përgjithshme e të hyrave të parashikuara për vitin 2017 është 1,725,000, 000 Euro nga të cilat 232,000, 000 Euro janë të gjeneruara nga taksat e drejtpërdrejta, d.m.th taksat e mbledhura direkt nga qytetarët e Kosovës. Gjatë viteve 2014 - 2017, të ardhurat e gjeneruara nga taksat janë shumë më pak se shpenzimet totale të pensioneve (shih tabelën e mësipërme). Me fjalë të tjera, të gjitha të ardhurat e mbledhura nga paratë e tatimpaguesit shkojnë për të mbuluar financimin e pensioneve të dikujt tjetër dhe nuk mjaftojnë.

Për më tepër, shtylla e parë e Kosovës financon gjithashtu pensionet e parakohshme për kategori të veçanta, gjithsej 6. Sllovenia sugjeron një qasje tjetër për të trajtuar kategoritë që nuk hynë në pensione të pleqërisë; për financimin e tyre, por jo përmes fondit të pensionit; por përmes krijimit të një fondi tjetër përfitues si pjesë e formave të tjera të ndihmës sociale[31]. Kjo është gjithashtu e pranishme në sistemin e Suedisë përmes pagesave të parakohshme[32]. Kjo praktikë rrit sistemin e pensioneve, sepse shteti ndihmon kategoritë që kanë nevojë për ndihmë para moshës 65 vjeç, pa rrezikuar dhënien e pensioneve të dyfishta; dhe ndryshe nga Kosova, qytetarët e Suedisë dhe Sllovenisë mundfillimisht të marrin një pension bazë pleqërie që nuk diskriminon pas moshës 65 vjeç.

Pensionet publike duhet të korrespondojnë me kontributet. Duke iu referuar skemave të pensioneve të Suedisë, individët paguajnë 7% të të ardhurave të tyre aktuale dhe disa përfitime sociale në formën e kontributit të përgjithshëm pensional. Punëdhënësit paguajnë 10.21 për qind të pagave aktuale në formën e kontributit të pensionit të pleqërisë. Kjo bën një total prej 17.21 për qind të pagave ose pagesa të tjera. Varësisht nga situata, këto mund të marrin forma specifike nga mjaftueshmëria relative (bazuar në standardin e kaluar të jetesës), mjaftueshmëria absolute (të ardhurat deri në standardin absolut të dakorduar të jetesës) dhe pjesërisht relative dhe pjesërisht absolute (përfitime më të mëdha për dollarin e kontribuar për grupet me të ardhura më të ulëta). Kjo e fundit është veçanërisht e rëndësishme për Kosovën dhe grupet me të ardhura të ulëta. Për

[31]Ministry of Labour, Family, Social Affairs and Equal Opportunities, (2009) Modernization of the Pension System in the Republic of Slovenia. [Online]. Available at:
[32]Ministry of Health and Social Affairs. "The Swedish Pension Agreement and Pension Reform" (2009), [Online].

shembull, pensionet që janë në dispozicion për njerëzit që kanë qenë të punësuar para vitit 1999, dorëzohen përmes buxhetit të shtetit në bazë të shkallës së shkollimit të fituar, në vend të punës (fitimprurëse). Duke i shqyrtuar përsëri vitet '80 dhe në fillim të viteve 90, shumë njerëz që dëshironin të regjistroheshin në institucionet arsimore iu mohua kjo mundësi për arsye politike. Rrjedhimisht, më vonë ata u bënë të paaftë për të gjetur një punë që sot do t'u siguronte pensione më të mira. Aktualisht, këta njerëz marrin pensionin minimal. Pasi janë diskriminuar një herë, ky grup i njerëzve ri-diskriminohet sërish përmes skemës aktuale të pensioneve. Skema pensionale pjesërisht absolute e moshës së vjetër mund të jetë një opsion për këtë grup me të ardhura më të ulëta për të pasur trajtim më të barabartë nga qeveria. Megjithatë, në çdo rast tjetër, kontributet pensionale duhet të kenë lidhje direkte me punësimin fitimprurës.

Në tërësi, pensionet nuk pengojnë stimujt e punës. Pensionet janë një komponent i rëndësishëm i kompensimit; stimujt që lidhen me planet e pensioneve ndikojnë në sjelljen e punëtorit[33] dhe mund ta çojnë shtetin në krijimin e dumpingut me pensione. Në përgjithësi, pritet që pas kontributeve gjatë gjithë jetës, punëtorët kanë më shumë gjasa të dalin në pension në moshën e specifikuar të pensionit, se sa ta lënë punën para se të arrijnë moshën e pensionimit. Rasti i Kosovës sugjeron të kundërtën - pikërisht për shkak të mungesës së kontributeve të punonjësve të kombinuar me sigurinë financiare që vjen përmes pensioneve të parakohshme të shtetit, zvogëlohen stimujt e punëtorëve për t'u bashkuar me fuqinë punëtore.

Për shembull, pensionet e parakohshmeqë u jipen ish-punonjësve të TMK-së, të cilët janë në moshën dyzet vjeçare, mesatarisht arrijnë shumën 280 euro; 280 euro është një pagë mesatare e mirë dhe për shumë nga marrësit ajo përbën një të ardhur të sigurtë[34]. Hulumtimi mbi pensionet minimale vlerëson se pensioni ndikon nëmaksimumin në moshën e pensionit të hershëm, duke e zvogëluar kështu ofertën e punës së punëtorëve të kualifikuar. Më tej, asistenca sociale jo-kontribuese në moshën e vjetër redukton stimujt e punës së punëtorëve të moshuar[35]. Kjo do të thotë se pensionet qëjanë marrë pa kontribute të mëparshme nga përfituesi. Në tregun e e punëstashmë konkurrues të Kosovës, këta punëtorë të kualifikuar mund lehtësisht të de-stimulohen për t'i vënë aftësitë e tyre në tregun e punës. Sigurisht, jo të gjithë de-stimulohen, sepse ka raste të përfituesve të pensionit që kanë një punë. Por, përsëri duke marrë një pension gjatë punës (dhe me këtë, duke u bërë i përshtatshëm për një pension tjetër) nuk është në përputhje me idenë e pensioneve.

Përfundimet

Sistemi i Pensioneve të Kosovës ishte planifikuar të ishte i thjeshtë dhe i qëndrueshëm nga ana financiare. Ideja qendrore pas kësaj thjeshtësie ishte që ta kishte shtyllën e dytë si kontribut të përcaktuar që do t'i mbulonte të gjitha pensionet e punësimit dhe universale për të gjithë të tjerët që nuk punojnë. Pas 16 viteve të këtij sistemi kemi 12 skema të ndryshme pensionale në shtyllën e

[33]Clark, Robert L. , Quinn, Joseph F. "Effects of pensions on labor market and retirement."(1999), ERISA/Brookings Institutions. [Online] Available at: http://www.bc.edu/content/dam/files/schools/cas_sites/economics/pdf/workingpapers/wp431.pdf
[34]Salihu, Njomza. "Pjesëtarët e TMK-së Marrin Rritjen e Pensioneve" (2012) Kallxo, [Online], Available at: http://kallxo.com/gjnk/pjesetaret-e-tmk-se-marrin-rritjen-e-pensioneve/

[35]Salihu, Njomza. "Pjesëtarët e TMK-së Marrin Rritjen e Pensioneve" (2012) Kallxo, [Online], Available at: http://kallxo.com/gjnk/pjesetaret-e-tmk-se-marrin-rritjen-e-pensioneve/

parë, 10 skema pensionale më shumë se në vitin 2002 me tendencë në rritje (pension për forcat e policisë, ligji mbi arsimin etj). Ndërkohë që shtylla e parë është financuar 100% nga buxheti i shtetit, kjo po bëhet gjithnjë e më shumë barrë e rëndë për Kosovën, në vitin 2017 kjo barrëpërbënte afër 340 milionë euro. Në të ardhmen e afërt, buxheti i Kosovës nuk do të ketë mundësinë t'i mbulojë të gjitha kostot e shtyllës së parë.

Shtylla e dytë megjithëse parashikohet të sigurojë pension për ata që punojnë dhe kontribuojnë në këtë shtyllë, nuk po e përmbush qëllimin e saj tani. 16 vjet pas futjes së kësaj shtylle, ata që kanë kontribuar në këtë shtyllë, marrin pensione mesatarisht për 26 muaj, pak më shumë se dy vjet. Llogaritjet me legjislacionin aktual mbi këtë shtyllë dhe zhvillime të tjera të ngjashme tregojnë se edhe nëse punojmë për 40 vjet nuk do të marrim pension për sa kohë që jetojmë.

Duke i pasur të gjitha parasysh, edhe sistemin aktual të pensioneve në Kosovë, është e sigurt që një ditë pas moshës 65 vjeç do të marrim një pension bazë (75 euro); pavarësisht nëse kemi punuar apo jo, pas moshës 73, të gjithë do të jemi të barabartë, të varfër dhe të vjetër. Në anën tjetër, sistemi aktual me anë të ligjeve të veçanta garanton pension për ata që janë të shëndetshëm dhe në fillim ose në mesin e viteve 30 që ata të marrin pension për aq kohë sa jetojnë.

Në kundërshtim me atë që u tha më lartë, sistemi aktual i pensioneve garanton se nëse jeni në fillim ose në mesin e viteve '30, jeni duke punuar, por një ditë keni një aksident në punë, dhe mbeteni të paaftë për punë me paaftësi prej 75% ose 80%, atëherë ju nuk merrni asgjë.

Rekomandimi nga ky punimështë i thjeshtë, të mos ketë më skema pensionale të reja, të mos ketë më ligj të veçantë për çdo kategorie, të fillojë reforma e sistemit të pensioneve. Shqyrtimi dhe reformimi i sistemit aktual të pensioneve në Kosovë është domosdoshmëri dhe jo zgjedhje politike.

"Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)."